

1 E enjte, 15 maj 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Seanca e apelit]

4 [Apeluesi paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 13.31

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirdita të
7 gjithëve, mirë se keni ardhur në sallën e gjyqit.

8 I lutem Sekretarit të seancës të paraqesë lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve.
10 Kjo është lënda KSC-CA-2024-03, Prokurori i Specializuar
11 kundër Pjetër Shalës. Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Vërej për procesverbal që z. Shala nuk është i pranishëm
15 fizikisht në sallën e gjyqit por që na ndjek përmes
16 videolidjes sot.

17 Z. Shala a po e ndiqni seancën në një gjuhë që e kuptoni?

18 APELUESI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita. Po, e dëgjoj
19 mirë dhe e kuptoj shumë mirë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Shala.

22 Ju lutem palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave të
23 prezantojnë ekipet e tyre. Të fillojë fillimisht avokati i z.
24 Shala.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Siç ju thatë, z.

Shala po na ndjek përmes videolidhjes. Unë jam kryeavokati i z. Shala. Bashkë me mua janë dy bashkëmbrojtësit, z. Aouini dhe znj. Leto Cariolou, kemi Dzeneta Petravica që është menaxhere e lëndës, kemi juristet Judit Kolbe, po ashtu juristen tjetër Alana Goncalves dhe dy stazhiere, znj. Seloua Ameziane dhe Imelda Mustafai. Unë jam z. Gilissen, Kryeavokati në këtë lëndë gjyqësore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
Faleminderit.

Ju lutem Zyrës së Prokurorit të Specializuar të prezantohet.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mëngjes të gjithëve. Nga ana e Prokurorisë sot është Kimberly West, Prokurorja e Specializuar, Maria Wong, Line Pederson, Max Karakul, Sarah Clanton, dhe unë vetë, Filippo de Minicis.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
Faleminderit.

I drejtohem tani Mbrojtësit të Viktimave të prezantohet.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Simon Laws, Avokati i Viktimave në këtë lëndë gjyqësore, dhe bashkë me mua është Maria Radziejowska, bashkëmbrojtësja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
Faleminderit.

Për procesverbal unë jam Michele Picard, Kryegjykatëse në këtë lëndë gjyqësore. Dhe kolegët e mi, në të djathtë është

1 Kai Ambos, në të majtën time është Gjykatësja Nina Jorgensen.

2 Kjo seancë është seancë apeli kundër aktgjykimit të
3 Trupit Gjykues dhe konstatimeve të këtij Trupi Gjykues sa i
4 takon përgjegjësisë së z. Shala, anëtar i Ushtrisë Çlirimtare
5 të Kosovës ose UÇK e thënë ndryshe, në disa ngjarje që kanë
6 ndodhur përafërsisht mes datës 17 maj 1999 dhe 5 qershor 1999
7 në ish-fabrikën e metalit në Kukës, Republika e Shqipërisë --
8 pra, fabrika e metalit të Kukësit ose për shkurt do t'i themi
9 thjesht fabrika paskëtaj.

10 Në aktgjykimin e 16 korrikut 2024, Trupi Gjykues
11 konstatoi se më së paku 18 persona ishin privuar nga liria e
12 tyre nga Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së; këta persona
13 janë mbajtur të ndaluar në këtë fabrikë në kushte çnjerëzore
14 degraduese dhe janë sulmuar në mënyrë të vazhdueshme si
15 fizikisht dhe psikologjikisht dhe se këto kanë ndodhur për një
16 qëllim të ndaluar; dhe së fundi, një person vdiq gjatë kohës
17 që është mbajtur i ndaluar në fabrikë, përafërsisht rreth
18 datës 5 qershor 1999 nga pasojat që i shkaktoi gjuajtja me
19 armë zjarri nga një anëtar i UÇK-së në praninë e Shalës, e
20 kombinuar kjo me mohimin e kujdesit mjekësor, mosdhënien e
21 kujdesit mjekësor, pra.

22 Trupi Gjykues e shpalli të akuzuarin fajtor për tri akuza
23 në aktakuzë për kryerjen e krimeve të luftës, gjegjësisht, se
24 ishin kryer si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët,
25 përndryshe NKP I, krimi i luftës i ndalimit arbitrar, sipas

1 akuzës 1; tortura, sipas akuzës 3; dhe vrasje e paligjshme,
2 sipas Akuzës 4.

3 Trupi Gjykses e shpalli të pafajshëm të akuzuarin për
4 krimin e luftës të trajtimit njerëzor -- çnjerëzor - më falni
5 - sipas Pikës 2, sepse gjykohe se kjo ishte konsumuar
6 tërësisht në krimin e luftës së torturës.

7 Më pas Trupi Gjykses e dënoi z. Shala me dënime të ndara,
8 gjashtë vjet burgim për krimin e luftës të ndalimit arbitrar,
9 16 vjet burgim për krime të luftës së torturës, dhe 18 vjet
10 burgim për krimin e luftës së vrasjes së paligjshme. Më pas
11 Trupi Gjykses i dha dënimin në total prej 18 vitesh burgim
12 duke marrë parasysh kohën në paraburgim.

13 Z. Shala paraqet 14 pika apeli kundër aktgjykimit. Ai
14 parashtro se Trupi Gjykses ka kryer disa gabime juridike dhe
15 faktike dhe ka gabuar në dhënien e dënit. Z. Shala kërkon që
16 Paneli i Apelit të prapësojë dënimin e tij dhe ta shfajësojë
17 për të gjitha akuzat; dhe/ose ta kthejë çështjen te Trupi
18 Gjykses për rigjykim; dhe/ose nëse është e nevojshme të japë
19 dënimin e duhur.

20 ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave e kundërshtojnë apelin
21 dhe kërkojnë që Paneli i Apelit ta rrëzojë ose tërësisht ose
22 pjesërisht.

23 Në përputhje me Urdhrin për Seancë që lëshua më 1 prill
24 2025, Paneli i Apelit do të dëgjojë sot edhe nesër parashtime
25 me gojë në vijim të apelit që dorëzoi z. Shala, do të dëgjojë

1 përgjigjet e ZPS-së dhe të Mbrojtësit të Viktimave, si dhe
2 kundërpërgjigjen Shala.

3 Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vëren si në vijim sa i
4 takon parashtrimeve nga Mbrojtësi i Viktimave. Paneli rikujton
5 se në Vendimin mbi Modalitetin e Pjesëmarrjes së Viktimave në
6 Procese Apeli, të lëshuar më 24 korrik 2024, Paneli i Apelit
7 vendosi se viktimat që kishim marrë pjesë në procesin paraprak
8 dhe gjatë gjykimit mund të merrnin pjesë në procesin e apelit
9 për sa kohë pjesëmarrja e tyre lidhej vetëm me pikat që janë
10 paraqitur për apel. Gjithashtu në përputhje me ligjin, Paneli
11 i Apelit përcaktoi se Mbrojtësi i Viktimave mund të bënte
12 parashtrime me gojë ose me shkrim përpara Panelit për sa kohë
13 ky avokat do ta bënte të qartë se si lidheshin këto
14 parashtrime me viktimat pjesëmarrëse të interesat e tyre
15 personale.

16 Gjatë kësaj seance, Paneli do të lejojë në përgjithësi,
17 parashtrime me gojë nga Mbrojtësi i Viktimave. Sidoqoftë,
18 Paneli vëren se do të marrë parasysh themelësinë -- në
19 themelësi parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave që janë në
20 përputhje me udhëzimet që janë paraqitur në Vendimin mbi
21 Modalitetin e Viktimave Pjesëmarrëse në Procesin e Apelit.

22 Tani do të përmbledh mënyrën se si do të zhvillohet kjo
23 seancë. Fillimisht dua t'i kujtoj palëve dhe pjesëmarrësve se
24 procesi i apelit nuk është gjykim *de novo*, nga e para, pra,
25 mos përsërisni edhe një herë argumentet që keni paraqitur

1 gjatë gjykimit. Këto argumente duhet të jenë të kufizuar në
2 gabime të pretenduara gjyqësore që e bëjnë të pavlefshëm
3 aktgjykimin, pretendime për gabime faktike që kanë krijuar
4 mohim të drejtësisë, apo gabime të pretenduara në vendin e
5 dënimit.

6 Gjatë seancës palët mund të paraqesin argumentet në
7 mënyrën që ata e gjykojnë më të përshtatshme. Palët dhe
8 pjesëmarrësit duhet t'i paraqesin parashtrimet në mënyrë
9 precize, të qartë dhe koncize dhe do t'i japin referencat të
10 sakta për materialet që mbështesin argumentet e tyre me gojë.

11 Paneli kujton po ashtu se, në Urdhrin për Përgatitjen e
12 Seancës për Apel që u lëshua më 5 maj 2025, u ka kërkuar
13 palëve dhe pjesëmarrësve, sipas rastit, të trajtojnë një sërë
14 pyetjesh specifike sa i takon pikave ku është mbështetur Trupi
15 Gjykses dhe provat e patestuara, është pika 7 e apelit;
16 dënimin e z. Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar,
17 është pika 12 e apelit; edhe vrasja paligjshme që është pika
18 13 e apelit; dhe dënimin e dhënë nga Trupi Gjykses në këtë
19 lëndë gjyqësore që është pika 14 e apelit.

20 Gjykatësit, sigurisht, mund të bëjnë edhe pyetje shtesë
21 qoftë gjatë kohës që palët bëjnë parashtrimet apo në fund të
22 parashtrimeve apo qoftë dhe në fund të seancës. Paneli i
23 Apelit thekson se i ka lexuar dosjet, kështu që ju lutem
24 palëve të mos përsërisni fjalë për fjalë atë që keni paraqitur
25 një herë ose thjesht bëni përmbledhje të argumenteve me

1 shkrim.

2 Gjithashtu doja t'ju rikujtoj të gjithëve se duhet të
3 respektojmë disa rregulla në mënyrë që procesi në sallën e
4 gjyqit të jetë një proces efektiv dhe të zbardhë gjithçka që
5 thuhet këtu.

6 Ju lutem kini parasysh se sa e nevojshme është që të
7 transkriptohet gjithçka dhe të bëhet përkthimi, kjo kërkon pak
8 më shumë kohë. Pasi të përfundoni fjalën bëni një pauzë, pra.
9 Ju lutem, mos harroni të ndizni mikrofonat. Kjo seancë po
10 transkriptohet në kohë reale dhe do të pasqyrohet në
11 transkriptin që të jetë -- do t'u jepet palëve dhe
12 pjesëmarrësve dhe publikut. Prandaj, ju inkurajoj të gjithëve
13 flisni ngadalë, bëni një pauzë prej dy sekondash është pasi
14 përfundoi njëri prej folësve.

15 Gjithashtu, ju lutem palëve të na njoftojnë paraprakisht
16 nëse ka ndonjë informacion konfidencial në gjërat që do të
17 thonë në mënyrë që të kalojmë në seancë private apo seancë të
18 mbyllur. Gjithashtu rikujtoj palët të jenë të kujdesshëm të
19 mos japin informacione që mund të identifikojnë ndonjë
20 dëshmitar të mbrojtur -- dëshmitar dhe viktimë.

21 Në përputhje me Urdhrin për Seancë të lëshuar më 1 prill
22 2025, axhendë ku -- dhamë dhe axhendën për sot seanca do të
23 jetë si në vijim. Sot do dëgjojmë parashtimet nga Avokati i
24 z. Shala për një orë e gjysmë. Pas një pushimi prej 30
25 minutash do të përgjigjet ZPS-ja parashtimeve të z. Shala për

1 një orë e 30 minuta. Nesër në mëngjes në orën 10.00 do t'u
2 përgjigjet Mbrojtësi i Viktimave parashtrimeve të z. Shala për
3 një orë. Më pas Avokati z. Shala do të ketë 20 minuta për t'u
4 kundërpërgjigjur. Pas kësaj z. Shala vetë do të ketë mundësinë
5 të bëjë ndonjë koment personal për Trupin Gjykues, për
6 Panelin.

7 Gjithashtu do të doja tani të ftoja avokatin e z. Shala
8 të fillonte me fjalën e vet. Keni kohë deri në orën 3.10 sepse
9 filluam pak më vonë kështu që do të jemi pak fleksibël, mbase
10 pak më vonë -- pak më shumë se aq.

11 Na falni për vonesën. Patëm një problem me kompjuterin.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk ka aspak problem.

13 Faleminderit, shumë faleminderit.

14 E nderuar Kryegjykatëse dhe të nderuar anëtarë të Panelit
15 të Apelit, faleminderit që më dhatë fjalën dhe që më dhatë po
16 ashtu shansin të paraqes edhe të shtjelloj argumentet
17 tona. Për shkak të kohës së kufizuar që kam ne duam ta
18 shfrytëzojmë këtë mundësi për argumente që ne i gjykojmë me
19 vlerë për zhvillimin e seancës dhe që kërkojnë vëmendje të
20 veçantë.

21 Z. Shala dhe Mbrojtja e tij vendosën të dorëzojnë apelin
22 përpara Panelit të nderuar të Apelit sepse ne besojmë se kemi
23 pasur disa vështirësi të mëdha me vendimin, aktgjykimin e
24 Trupit Gjykues. Pikërisht ne besojmë se ka problematika në
25 procedurën e ndjekur nga Trupi Gjykues si dhe në zbatimin e

1 ligjit siç përmendet në vendimin e lëshuar nga Paneli i Apelit
2 më 16 korrik 2024.

3 Së pari, si fillim ne besoj se kemi probleme reale dhe të
4 mëdha sa i takon faktit që Paneli është mbështetur në disa
5 prej deklaratave të z. Shala. Po gjithashtu gjykojmë se
6 vendimi për të përdorur disa prej këtyre deklaratave në
7 mënyrën se si i përdori ky Trup Gjykues janë një problem real
8 dhe jashtëzakonisht i madh. Kjo është baza e pikës 1 të apelit
9 tonë.

10 Pikërisht, ne vlerësojmë se vendimi për të pranuar disa
11 prej deklaratave të dhëna prej z. Shala dhe për t'i përdorur
12 ato në mënyrën si janë përdorur, për z. Shala janë bazë që i
13 ka shkaktuar një dëm të një natyre shumë të rëndë,
14 gjegjësisht: shpallja fajtor e z. Shala për tri krime lufte.

15 Për më shumë se 20 vitesh hetime, z. Shala ka dhënë disa
16 deklarata sikurse ju e dini në 2005, 2007, 2016 dhe 2019. Në
17 këto raste, siç e dini shumë mirë, asnjëherë nuk është marrë
18 në pyetje në praninë e një tani në një avokati. Mbi të gjitha
19 është marrë në pyetje pa iu dhënë mundësia fare të konsultohet
20 me një avokat apo -- kjo pikërisht kjo është pranuar nga
21 Paneli i Apelit në vendimin që është lëshuar më 5 maj 2023,
22 gjatë intervistës nga policia gjyqësore federale belge në
23 2016-n është cenuar e drejta e z. Shala për ndihmë
24 juridike. Pra, është e qartë nga vendimi i Panelit të Apelit
25 se e drejta e z. Shala për të drejtë juridike, në fakt, nuk u

1 garantuan. Sidoqoftë aktgjykimi mbi shpalljen fajtor vendosi
2 për herë të parë të pranonte si prova gjyqësore deklaratat që
3 ka bërë z. Shala në 2016-n si dhe ato që ka dhënë më pas në
4 vitin 2019.

5 Pra, përpara se të lëshohet vendimi i Panelit të Apelit,
6 Trupi Gjykses deklaroi se deklaratat e 2016-s dhe 2019-s
7 ishin, dhe po citoj, "të disponueshme për t'u marrë parasysh"
8 për kuvendimin për qëllim të aktgjykimit. Tani unë kam këtë
9 pyetje: Cili është statusi i këtyre deklaratave? Si mund të
10 pozicionohet Mbrojtja në një situatë të tillë?

11 Dhe unë po ju them, mund t'ua them, unë mund t'ua them:
12 Çfarë është kjo? Për çfarë është kjo? Këto elemente nuk janë
13 pranuar si provë gjyqësore. Nuk kanë marrë numrin përkatës,
14 qoftë provizor, qoftë numër prove, atëherë ku mund t'i gjejë
15 Mbrojtja këto joprova, sepse në dokumentacionin gjyqësor nuk
16 janë. Mbrojtja ku mund t'i gjejë këto rregullat, rregulloret
17 specifike lidhur me këto elemente? Po ju them elemente shumë
18 të veçanta, sepse këto elemente nuk janë pjesë e provave
19 gjyqësore, sepse nuk janë pranuar ndonjëherë si të tilla dhe
20 nuk janë të përfshira në dokumentacionin gjyqësor. Janë
21 thjesht, në thonjëza "elemente" por nuk janë prova. Është
22 qartë, është e qartë pra, që ta konsiderosh këtë element dhe
23 të thuash që ky është element po mund të merret parasysh dhe
24 këto elemente mund të përdoren për të shpallur fajtor z.
25 Shala.

Çfarë vlere provuese paska një koncept i tillë? Nuk ekziston një gjë e tillë. Kjo është e sigurt. Dhe cilësia, më falni, e provave diku, e provave, kur them provave diku të hedhura dikur ose që mund të ishin prova nuk mund të ekzistojë, nuk mund të pranohet kjo sepse kjo krijon probleme të mëdha dhe të rëndësishme. Të njëjtën pyetje bëj për statusin e kësaj të ashtuquajture kategorie të re elementesh që nuk janë të pranuar dhe as të përfshira në dokumentacionin gjyqësor.

Veç kësaj, është e qartë nga aktgjykimi se deklaratat e 2019-s janë përdorur më së paku dhjetë -- në dhjetë raste dhe janë përdorur si baza për të shpallur fajtor z. Shala. Dhe këtu kemi një problematikë, për mendimin tim, një problematikë shumë të madhe juridike: cenim të drejtës së z. Shala për gjykim të drejtë. Sepse nëse Mbrojtja e konteston vendimin e Trupit Gjykues për të pranuar deklaratat joinkriminuese të z. Shala, pra konkretisht bëhet fjalë për 2016-s, 2019-s, kjo është mbi të gjitha është një gjë shumë e veçantë mënyra se si disa për informacioneve dhe përmbajtja e këtyre deklaratave janë përdorur kundër z. Shala dhe ç'ka për ne janë baza për apelin.

Nuk është vetëm çështje këtu të rishqyrtohet vendimi për pranueshmërinë, është më shumë, shumë më shumë sesa kaq. Në fakt z. Shala nuk ka qenë dëshmitar. Ai nuk vendosi të dilte në bankën e dëshmitarëve nën betim dhe të jepte dëshmi gjatë

1 gjykimit të tij. Prandaj mënyra se si këto deklarata janë
2 marrë parasysh është shumë problematike.

3 Si ka mundësi që deklarata që ka bërë vetë një i akuzuar
4 të cilat nuk janë verifikuar dhe as nuk janë kontestuar në një
5 seancë, si mund të përdoren në këtë formë? Është rëndësishme
6 të merren parasysh pasojat që ka pranimi deklaratave të
7 pakontestuar në një proces ligjor. Ju lutem keni parasysh që
8 askush, askush nuk mund ta përpunojë apo përdorë dëshminë e
9 një dëshmitari madje, as të një dëshmitari madje nuk mund të
10 pranohet në këtë formë.

11 Çfarë është ndryshe me deklaratën e dëshmitarit, çfarë
12 ndodh me një dëshmitar që nuk verifikohet në një seancë? Nuk
13 ka se si të pranohet një deklaratë e tillë as për të
14 akuzuarin. Askush nuk mund të mbështetet ekskluzivisht apo në
15 një shkallë të konsiderueshme për deklaratat e një dëshmitari.
16 Dhe unë prapë theksoj që z. Shala nuk ka qenë dëshmitar. Ai ka
17 qenë dhe është i akuzuar.

18 Po çfarë ndodh? Trupi Gjykses e pranoi. E pranoi, pranoi
19 deklaratat e një të akuzuari. Pikërisht këtë bëri.

20 Dhe jo vetëm kaq, për në qoftë se një i akuzuar nuk mund
21 të detyrohet të japë dëshmi në gjykimin e vet, atëherë si mund
22 të përdoren deklaratat e kontestuar të këtij personi? Si mund
23 të pranohen deklarata që nuk janë kontestuar apo diskutuar
24 gjatë një seance. Dhe kjo ka ndodhur edhe në kushtet dhe
25 mënyra se si janë marrë deklaratat e tij, sepse janë marrë në

1 kushte problematike edhe kontestohen në përmbajtje.

2 Është e rëndësishme të rikujtojmë pse një pjesë e
3 deklaratave -- e incizimeve - më falni - të deklaratës së z.
4 Shala nuk është dhënë asnjë Mbrojtjes. Dhe Mbrojtja dëshiron
5 ta verifikojë. Çfarë elementësh kanë pasur në këto incizime,
6 ku është bazuar, pra, Prokurori për këto deklarata sepse
7 incizimi ka humbur. Pra ka humbur. Ne jemi në kushte që ne nuk
8 dimë asgjë çfarë përmbante ky incizim.

9 Pra, kjo do të thotë që nuk ka mundësi që Mbrojtja, po as
10 Gjykatësit, pra edhe Gjykatësit s'e verifikojnë dot cilësinë e
11 elementëve të administruar apo një pjesë të elementeve të
12 administruar nga Prokurori në këtë lëndë gjyqësore. S'ka
13 asgjë, asgjë s'është thënë për këtë nga Trupi Gjykses në
14 vendimin e tyre.

15 Mbi të gjitha, duhet sikur mënyra se si i ka përdorur
16 Trupi Gjykses disa pjesë të deklaratave ka qenë pikërisht për
17 të kthyer barrën e provës. Në fakt, Trupi Gjykses ka thënë se
18 deklaratat e z. Shala, dhe po citoj, "nuk ja kanë dalë të
19 diskreditojnë" provat e paraqitura në gjykim. Më falni, po nuk
20 ka pse ta bëjë Mbrojtja këtë. S'është kjo detyra jonë. S'është
21 kjo puna jonë. Mbrojtja nuk ka pse të diskreditojë deklaratat
22 e z. Shala. Z. Shala s'i dhënë deklaratat për diskredituar
23 askënd, as për të kontestuar provat e Prokurorisë. Z. Shala
24 thjesht ka paraqitur qëndrimin e tij dhe nuk është -- nuk ka
25 pse t'i vendoset barra e provës në shpatullat e tij.

1 Mendoj se duhet të fokusohemi në faktin se deklaratat e
2 z. Shala as nuk i trajtojnë shumë prej pikave që Trupi Gjykses
3 gabimisht ka pritur që të vërtetoheshin apo jo nga këto
4 deklarata. Pra, nuk është thjesht që kanë dalë me konstatime
5 lidhur me z. Shala për barrën e provës, peshën e barrës së
6 provës, Trupi Gjykses shkoi dhe më tej dhe mori parasysh
7 heshtjen e z. Shala lidhur me disa aspekte të caktuara, dhe
8 këto konstatime patën efekt negativ tek ai dhe cenuan
9 prezumimin e pafajësisë. Unë këtë mund ta quaj një cenim të
10 dyfishtë, madje dhe të trefishtë.

11 Veç kësaj, duhet të kuptojmë se sa -- se si deklaratat e
12 2019-s kanë qenë tërësisht të frymëzuara nga deklaratat e
13 dhëna në 2016-n. Në fakt, deklaratat e 2016-s të z. Shala janë
14 baza, baza reale e deklaratave që ka dhënë në 2019-
15 n. Deklaratat e 2019-s janë thjesht një vijimësi e deklaratave
16 të 2016-s. Realiteti është se në 2019-n dija, dijenia e
17 hetuesve është bazuar në deklaratat e z. Shalat të 2016-
18 s. Duhet të kuptojmë se informacioni që përmbajnë këto
19 deklarata është materiali mbi bazën e të cilit hetuesit
20 përgatitën intervistën e tyre në 2019-n. Pra, deklarata e
21 2016-s është burimi dhe ajo që ka vijuar më pas në deklaratën
22 e 2019-s të z. Shala. Lidhur me këtë pikë mund të mbërrijë në
23 përfundimin që një gjë është e sigurt, që deklaratat e z.
24 Shala në vitin 2019 nuk do të kishin qenë të njëjtat. Edhe një
25 herë theksoj nuk do të kishin qenë asnjëherë të njëjtat në

1 goftë se deklarata e 2016-s nuk do të kishte ekzistuar ose në
2 goftë se hetuesit nuk do i kishin marrë parasysh fare ato.

3 Kjo është arsye se pse ne i referohemi asaj që quhet
4 "doktrinë e pemës së helmuar". Jam shumë i sigurt që ju e keni
5 dëgjuar këtë doktrinë, pasi kjo është një doktrinë shumë e
6 mirënjohur.

7 Parregullsitë dhe paligjshmëritë që prekin këto deklarata
8 duhet që të parandalojnë përdorimin e tyre në Gjykatë dhe
9 sigurisht që nuk duhet të përdoren në një vendim fajësimi. Sa
10 i takon drejtësisë së procedurës, dhe kjo është diçka e cila
11 është në pikëpyetje sepse e gjithë kjo komprometohet nga
12 parregullsia dhe paligjshmëria e procesit gjyqësor. Sipas
13 pikëpamjes time unë nuk e kuptoj dot se si një deklaratë e
14 fajësisë në kushte të tilla nuk mund të cenohet ose të
15 njolloset nga problemet e shumta të cilat po i diskutojmë
16 sot.

17 Për këtë arsye Mbrojtja ka ngritur këto çështje ligjore
18 dhe procedurale si pjesë e pikës së parë të apelit të
19 aktgjykimit kundër z. Shala.

20 Paneli i Trupit Gjyqësor ka pranuar këto deklarata në
21 prova gjyqësore dhe kjo është diçka të cilën ne e kontestojmë
22 forcë. Në fakt, në momentin e intervistave z. Shala i cili nuk
23 ka përfunduar arsim të plotë ka qenë vërtet një person i
24 cenueshëm. Ai gjithashtu ka qenë jo në gjendje që të vlerësojë
25 plotësisht sa e rëndë ishte situata dhe çfarë rëndësie kishte

1 ajo për të. Dhe unë mendoj që kjo është e pabesueshme dhe
2 sipas mendimit tim është edhe e papranueshme pasi në një
3 situatë të tillë ai nuk është informuar për domethënien e të
4 drejtës së tij për ndihmë juridike, dhe në qoftë se ai nuk
5 është informuar as për të drejtën për pasur ndihmë juridike pa
6 pagesë.

7 Kështu që në kushte të tilla si është e mundur, pra, në
8 qoftë se flitet për hetues profesionistë, për persona të cilët
9 kanë si detyrë që të bëjnë me dijeni të drejtat që kishte z.
10 Shala në atë kohë, pra këto janë të drejta të parashikuara me
11 ligj për z. Shala. Kështu që në një situatë të tillë si është
12 e mundur që të mos bëhet një përmbledhje e këtyre të drejtave
13 dhe vetëm thjesht ata vazhdojnë, dhe dua këtu të citoj, thonë
14 "bla, bla, bla". Domethënë këta janë hetues të cilët as nuk
15 kanë marrë mundimin që të lexojnë të drejta të tilla. Ky është
16 i vetmi shpjegim që ka marrë z. Shala "bla, bla, bla". Mendoj
17 që kjo është shumë domethënëse. Kjo tregon shumë lidhur me
18 profesionalizmin e këtyre hetuesve dhe të informacionit që ka
19 marrë z. Shala prej tyre.

20 Përveç kësaj, më duhet të them, duket që z. Shala është
21 ndjerë i detyruar të mos besohet -- të mos mbështetet te
22 përkthyesi që ka pasur në dispozicion. Për këtë arsye ai ka
23 preferuar që të komunikojë në frëngjisht, pavarësisht aftësive
24 gjuhësore në të kufizuara në frëngjisht dhe pavarësisht
25 kompleksitetit të çështjeve të cilat po diskutoheshin.

1 Gjithashtu duket se përkthyesit në intervistat në Belgjikë nuk
2 kanë qenë përkthyes të pavarur, por kanë qenë përkthyes të
3 lidhur me policinë belge dhe, në të vërtetë, ne nuk kemi asnjë
4 informacion sa i takon kompetencës së tyre, cilësisë së punës
5 së bërë prej tyre, përmbushmërisë të trajnimeve ose madje edhe
6 diplomave të përkthyesve të tillë. Kjo është një çështje shumë
7 e rëndësishme sepse dëshiroj të theksoj faktin që ky lloj
8 problemi i vazhdueshëm ka pasur pasoja në Belgjikë. Në fakt
9 ligjvënësit belge kanë ndryshuar ligjin për shkak të
10 problemeve të ngritura dhe kanë miratuar ligjin e datës 5 maj
11 2019. Dhe kjo është një datë e cila është shumë e rëndësishme,
12 pra është një ligj shumë i rëndësishëm që është pasuar më pas
13 nga një qarkore me numër 284, me datë 1 mars 2012. Pra,
14 arsyeja e një ligji të tillë është që të shmangej një situatë
15 e ngjashme dhe për këtë arsye është e rëndësishme për
16 Mbrojtjen e Shalës për të pasur qasje në regjistrimet e këtyre
17 intervistave në mënyrë që të ketë mundësi që të kontrollojë
18 cilësinë, pra cilësinë e vërtetë, reale të këtyre elementëve
19 që jepen apo ofrohen nga Prokuroria. Por, sikurse e thashë
20 edhe më përpara duket sikur një gjë e tillë është tërësisht e
21 pamundur për ne, por është e pamundur dhe për ju, të nderuar
22 Gjykatës. Është e pabesueshme të dëgjohet që regjistrime të
23 tilla janë të paqashme, pra janë regjistrime të cilat thuhet
24 që janë humbur. Megjithatë ne nuk e dinë fare se në çfarë
25 kushtesh janë humbur. Megjithatë parashtrimi ynë është që

1 kushtet janë të pabesueshme.

2 Në qoftë se kjo do ishte shaka, nuk besoj që ndokush do
3 qeshte me këtë. Megjithatë si duhet të reagojmë si duhet që të
4 sanksionohet një shkelje e tillë në procedurë, një
5 mospërbushje e tillë në procedurë. Dhe duket që për vendimin
6 për aktgjykimin kjo ka qenë shumë e thjeshtë. Megjithatë,
7 pavarësisht të gjithave Trupi Gjykses i ka pranuar këto
8 deklarata në prova gjyqësore sikurse e gjithë kjo çështjet të
9 mos ekzistonte fare, sikurse të mos kishte asnjë lloj problemi
10 të vetëm. Ndërkohë nuk ka thënë qoftë edhe një fjalë të vetme
11 lidhur me këtë.

12 Trupi Gjykses gjithashtu ka vendosur që të mbështetet në
13 këto deklarata, pra deklaratat e 2016-s dhe deklaratat e 2019-
14 s, dhe më duhet të them që këto deklarata luajnë një rol shumë
15 të rëndësishëm në aktgjykim dhe janë pjesë e provave mbi cilat
16 është mbështetur vendimi i fajësisë. Më duhet të them që
17 mbështetur në këto kushte është cënuesë, shume cënuesë do
18 thosha, për të respektuar rregullat dhe për këtë arsye më
19 duhet të them që gjërat duhet që të mbështeten në rregulla.

20 Jo vetëm kaq, por Mbrojtja deklaron që në mënyrë të tillë
21 që të vendoset që të përdoren deklarata të tilla nga Gjykata,
22 nga Trupi Gjykses në vendimin e fajësisë, është më
23 problematike dhe është më shumë cënuesë nga pikëpamja ligjore
24 dhe në përputhje me rregullat themelore të prezumimit të
25 pafajësisë si dhe garancive të procesit të rregullt gjyqësor

1 dhe të procesit të drejtë gjyqësor.

2 Më lejoni të shtoj gjithashtu që të përdorësh deklaratë
3 të tilla është e padrejtë, por t'i përdorësh ato pa asnjë
4 përpjekje të vetme për të ndrequr situatën gjatë procesit
5 gjyqësor, gjatë gjykimit është padyshim diçka e
6 padrejtë. Duhet t'ju them se shkelja e të drejtave të z.
7 Shala, sikurse është njohur nga vendimi i apelit që është
8 lëshuar me 5 maj të vitit 2023, sipas aktgjykimit, nuk ka
9 pasoja fare, absolutisht nuk ka as edhe një pasojë të vetme,
10 madje nuk ka pasojë edhe sa i takon dënimit të z. Shala.

11 Kjo ishte pika e parë që dëshiroja të ngrija për ju, të
12 nderuar anëtarë të Trupit Gjyqësor, por përveç kësaj, dhe kjo
13 është një temë më vete, dëshiroj të përqendrohem gjithashtu në
14 faktin se duke vepruar siç ka vepruar Trupi Gjyqësor, Trupi
15 Gjyqësor ka dështuar që të sigurojë, që të ofrojë ose garantojë
16 sigurinë sa i takon provave të administruara në procesin
17 gjyqësor. Dhe kjo është baza e pikës së dytë të apelit tonë,
18 që është pika numër 2, pra, cenimi shkaktuar nga pasiguria e
19 provave të administruara.

20 Në fakt, Trupi Gjyqësor duhet që të vendosë sa i takon
21 pranueshmërisë së provave të paraqitura përpara tij, pra
22 përpara Trupit Gjyqësor, sikurse ju e dini më mirë sesa
23 mua. Kjo do të thotë se Trupi Gjyqësor duhet që të përcaktojë
24 në qoftë se provat duhet të pranohen si të tilla, pra duhet
25 pranohen si prova gjyqësore apo jo. Për ta bërë diçka të tillë

1 Trupi Gjykuesi duhet të lëshojë, pra është kërkesë, është
2 kërkesë për Trupin Gjykues që të lëshojë një vendim
3 pranueshmërie ose disa vendime pranueshmërie lidhur me të
4 gjitha provat që janë paraqitur përpara tij.

5 Sigurisht koha për lëshimin e vendimeve të tilla është
6 thelbësore, dhe është thelbësore për të gjitha palët në
7 veçanti është thelbësore për Mbrojtjen. Pse është kaq shumë e
8 rëndësishme për Mbrojtjen? Është e rëndësishme për Mbrojtjen
9 sepse për ne është absolutisht shumë e domosdoshme që të jemi
10 plotësisht të informuar dhe të jemi të vetëdijshëm për provat
11 e pranuar në lëndën gjuhësore, sepse në fund të ditës kjo
12 është ajo për të cilën ne do të diskutojmë. Pra, këto vendime
13 pranueshmërie përcaktojnë provat që ekzistojnë kundër të
14 akuzuarit. Pra cilat janë këto prova kundër të akuzuarit dhe
15 pse provat kundër të akuzuarit, për shembull, është kjo provë
16 dhe jo një provë tjetër.

17 Pra, qartazi koha e duhur për lëshimin e vendimeve të
18 pranueshmërisë është në çdo kohë para sesa të përfundohet
19 procesi i administrimit të provave nga Trupi Gjykues. Përpara
20 Dhomave të Specializuara të Kosovës procedura është shumë e
21 qartë dhe mund të them që jo vetëm se është e qartë por
22 gjithashtu ka edhe kuptim. Në fakt, në pajtim me nenin
23 40(6)(h) për vendimin e pranueshmërisë, ky moment edhe këtu
24 citoj, "për mbylljen e administrimit të provave" ndodh
25 "përpara ose gjatë procesit gjykim", sepse duhet që palët të

1 lejohen që të kenë një mundësi efektive për të trajtuar të
2 gjitha provat e administruara, gjithashtu duhet që të japë një
3 mundësi për palët që të vendosin si të zhvillojnë çështjen e
4 tyre, por gjithashtu edhe që të diskutojnë dëshmitë e
5 regjistruara. Kjo kërkohet nga përzgjedhja e procedurave vetë.
6 Gjërat duhet të jenë absolutisht të qarta përpara paraqitjes
7 së deklaratave përmyllëse të palëve. E përsëris edhe një
8 herë, kjo ka kuptim plotësisht.

9 Pra, ta bësh këtë punë në aktgjykim nuk është në
10 përputhje me parashikimet dhe në fakt fjalët "gjatë gjykimit"
11 nuk mund të konsiderohen si të njëjta me "aktgjykim",
12 sigurisht. Domethënë, këto janë dy pika të ndryshme sa i takon
13 kohës.

14 Sikurse e dini, gjatë procedurave Trupi Gjykses ka
15 konstatuar se deklaratat e 2016-s dhe 2019-s nuk ishin, dhe
16 këtu citoj, "të papranueshme" dhe citoj përsëri, "mund të
17 konsiderohen nga Trupi Gjykses në përputhje me rregullën 131
18 [Sipas përkthimit] paragrafi 1". Megjithatë, Trupi Gjykses
19 shtoi se, dhe këtu citoj përsëri, "lidhur me pyetjen në qoftë
20 se do të pranohen në prova gjyqësore" dy deklaratat, "Trupi
21 Gjykses do të nxjerrë në kohë të përshtatshme vendimin për
22 pranueshmërinë -- për parashtrimin dhe pranueshmërinë e
23 provave jогоjore".

24 Pra, në qoftë se "të pranojë në prova", nuk mund të them
25 në qoftë se gjë tillë mund të duhet të thotë në qoftë se

1 "duhet të kemi, ne duhet të pranojnë prova të tilla" ose na
2 duhet të vendosim lidhur me të. Pra, për këtë arsye, pra, ne
3 si Mbrojtje na është dashur që të përballemi me një situatë
4 shumë të veçantë dhe më duhet të them që situata për ne ka
5 qenë e pakëndshme dhe jo e rehatshme. Por duhet ta theksoj
6 edhe një herë tjetër që situata ka qenë në çdo rast një
7 situatë e paligjshme, dhe pa diskutim, një situatë padrejtë.

8 Përdorimi i pranueshmërisë së provave dhe themelësia e
9 deklaratave inkriminuese të bëra nga z. Shala janë kontestuar
10 në mënyrë të vazhdueshme dhe fort nga Mbrojtja dhe nuk ka
11 ndodhur asgjë, domethënë, nuk është dhënë asnjë vendim, asnjë
12 vendimi i arsyetuar lidhur me kontestimin e Mbrojtjes dhe nuk
13 kemi marrë asnjë vendim të tillë në kohën e përshtatshme.

14 Megjithatë Trupi Gjykses ka trajtuar argumentet e
15 Mbrojtjes lidhur me të gjitha këto probleme përfshirë këtu dhe
16 argumentet e përfshira në dosjen gjyqësore paraprahe të
17 Mbrojtjes.

18 Trupi Gjykses ka vendosur gabimisht të kundërtën. Dhe ky
19 është gabim, edhe ky është një gabim i cili mund të shpjegojë
20 situatën që ne të gjithë po trajtojmë në nivel apeli. Në
21 realitet Mbrojtjes i është mohuar çdo mundësi efektive për
22 t'iu përgjigjur themelësive të çështjeve të ngritura në prova
23 të ofruara për të pranuar, por që nuk janë pranuar ende nga
24 Trupi Gjykses. Ju kujtoj të gjithë që këtu për flasin për
25 deklarata, nuk po flasim për dëshmi me gojë. Deklaratat e bëra

1 nga z. Shala, i cili nuk është dëshmitar në këtë proces
2 gjyqësor por akuzuar, i cili ka të drejtën që të qëndrojë i
3 heshtur, pra të drejtën për të mos vetëinkriminuar
4 vetveten, dhe madje ka edhe të drejtën për të gënjyer, sikurse
5 ju e dini.

6 Pra, duke vepruar siç ka vepruar, Trupi Gjykses, së pari,
7 nuk ka respektuar procedurën dhe rregulloret e KSC-së, pra, të
8 Dhomave të Specializuara të Kosovës; së dyti, Trupi Gjykses ka
9 dhunuar apo nuk ka respektuar të drejtat e z. Shala; së treti,
10 Trupi Gjykses ka cenuar seriozisht të drejtat e Mbrojtjes për
11 të qenë plotësisht në dijeni të dëshmive në këtë lëndë
12 gjyqësore për të pasur kohë të mjaftueshme dhe mjete të
13 mjaftueshme për të përgatitur provat e veta, dhe ka cenuar
14 edhe mënyrën e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

15 Si është e mundur që të trajtohen siç duhen deklarata
16 inkriminuese kur ti nuk e di në qoftë se deklarata të tilla
17 janë të pranuar si prova gjyqësore apo jo, janë pjesë e
18 provave të administruara apo jo? Duhet ta marrësh me mend?

19 Më duhet të theksoj në këtë moment se nuk ka pasur asnjë
20 mundësi që Mbrojtja të shkojë përpara Panelit të Apelit lidhur
21 me këtë situatë edhe për të shmangur pasojat e një situate të
22 tillë. Më duhet të shtoj gjithashtu që është shumë e
23 rëndësishme të theksohet që një situatë të tillë në të cilën
24 është vendosur Mbrojtja ka qenë një situatë e përsëritur dhe
25 në nivele të tjera gjatë procedurave gjyqësore.

1 Në fakt, ndërkohë që aktgjykimi i referohet nëntë
2 viktimave qartësisht të identifikuara dhe e ka, në fakt, ka
3 ngarkuar përgjegjësinë -- me përgjegjësi penale z. Shala sa i
4 takon këtyre nëntë viktimave të identifikuar qartësisht,
5 vendimi i dënimit në aktgjykim lidhej me 18 viktima të
6 identifikuara, pa asnjë lloj ndryshimi të mundshëm në aktakuzë
7 dhe asnjë moment mundshëm.

8 Z. Shala është dënuar dhe është shpallur fajtor për krime
9 të cilat nuk janë përmendur fare në aktakuzë. Këto viktima të
10 cilat janë identifikuar më tej, nuk kanë qenë pjesë fillimisht
11 e çështjes Prokurorisë, dhe Prokuroria nuk i ka identifikuar
12 asnjëherë këto viktima plus të identifikuara. Nuk i ka
13 intervistuar asnjëherë ato, ose madje as nuk i ka lëshuar dhe
14 një fletëthirrje për to. Prokuroria nuk ka thënë asnjëherë
15 gjatë gjykimit dhe nuk i ka përmendur këta persona të
16 identifikuar si viktima.

17 Kjo do të thotë që Mbrojtja asnjëherë nuk ka pasur
18 mundësinë, së pari, të hetojë; së dyti, të kontestojë; së
19 treti të diskutojë; ose së katërti, të paraqesë një mbrojtje
20 sa i takon këtyre nëntë personave shtesë të ashtuquajtur
21 viktima të identifikuara. Dhe Prokuroria nuk ka kërkuar asnjë
22 ndryshojë qëndrimin e vet sa i takon këtyre nëntë personave
23 shtesë, të quajtur viktima të identifikuara, të cilët e
24 përsëris edhe njëherë nuk janë përfshirë në aktakuzë apo nuk
25 janë thirrur si dëshmitarë apo nuk kanë marrë asnjë

1 fletëthirrje për t'u paraqitur para Trupit Gjykues.

2 Kjo është baza e pikës 5 të apelit tuaj -- tonë - më
3 falni. Pra nuk kemi pasur asnjë lloj mundësie për të pasur një
4 mbrojtje reale dhe efektive ndaj këtyre personave. Ne madje as
5 nuk e dimë se çfarë kanë për të thënë këta persona për të
6 ashtuquajturën viktimizim të tyre ose mungesë viktimizimi. Ne
7 nuk dinë fare çfarë mund të thonë persona të tillë.

8 Më tej aktgjykimi ka identifikuar dhe ka shtuar persona
9 të caktuar përveç personave të përmendur në aktakuzë si pjesë
10 e ndërmarrjes kriminalet përbashkët që pretendohet se kanë
11 vepruar në Kukës. Aktgjykimi ka shtuar këta persona ndërkohë
12 që Prokurori në vetvete kurrë nuk ka mbështetur një version të
13 tillë të fakteve dhe nuk është shprehur sa i takon
14 pjesëmarrjes së këtyre personave në ndërmarrjen kriminale të
15 përbashkët ose në krimet e ndjekura penalisht. Edhe një herë
16 tjetër, kjo nuk është lënda e Prokurorisë. Dhe më duhet të
17 them dhe nuk është kjo -- nuk është ky qëndrimi Prokurorisë,
18 dhe disa prej këtyre personave të shtuar kanë qenë dëshmitarë
19 për vetë Prokurorinë. Kjo në vetvete ka krijuar një problem të
20 ri dhe shtesë lidhur me vendimin që ne kemi apeluar dhe për
21 këtë arsye është një ndër pikat e apelit tonë.

22 Edhe një herë, Mbrojtja është deprivuar nga çdo mundësi
23 për të kryer hetime, për të kontestuar, për të diskutues ose
24 për të paraqitur një mbrojtje lidhur me këto pika. E vendosur
25 dhe e gjendur në një situatë të tillë, në një situatë të tillë

1 procedurale, në fund të procesit gjyqësor, ne për herë të parë
2 kemi dëgjuar që këta persona kanë qenë pjesë e pretenduar e së
3 ashtuquajturës ndërmarrje kriminale përbashkët, pra, kur u
4 shpall, kur u dha aktgjykimi për z. Shala, ne e morëm vesh
5 lidhur me këta persona.

6 Pa diskutim që z. Shala nuk ka përfituar nga procesi i
7 rregullt. Mbrojtja pa diskutim që nuk është informuar
8 asnjëherë për ndryshime të tilla procedurale ose për persona
9 të tillë. Edhe sikurse e thashë dhe më përpara, ne kemi pasur
10 të drejtë të informohemi përpara mbylljes së procesit gjyqësor
11 dhe përpara fundit të debatit. Kështu që në këto kushte është
12 normale që të thuhet që z. Shala e konsideron veten që të jetë
13 vënë në një kurth të vërtetë.

14 Do ndaloj këtu, dhe në qoftë se më lejoni, të nderuar
15 Gjykatës, dhe sigurisht nën kontrollin tuaj, unë propozoj që
16 tani t'i jap fjalën z. Aouini së pari edhe më pas znj.
17 Cariolou do vazhdojë më tej. Z. Aouini do të vazhdojë që të
18 paraqesë argumente të cilat kanë të bëjnë me pikat 6 deri 11,
19 dhe znj. Cariolou do të vazhdojë që t'i përgjigjet pyetjeve
20 tuaja sikurse është kërkuar në urdhrin tuaj që mban datën 5
21 maj 2025.

22 Ju falënderoj shumë. Faleminderit edhe një herë për
23 vëmendjen. Faleminderit për mundësinë që na dhatë. Kështu që,
24 në qoftë se më lejoni, dua t'i jap fjalën kolegut tim dhe
25 pastaj do të vazhdoj në fund për sa i takon pjesës së

1 përmbylljes për propozimet në vijim.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.

3 Z. Aouini, mund të vazhdoni më tej.

4 Z. AOUMINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

5 Faleminderit, z. Gilissen.

6 Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj propozoj që të ngre
7 disa pika të cilat kanë të bëjnë me pikat nga 6 deri në 11 të
8 dosjes për apelim.

9 Do filloj aty ku e la z. Gilissen, do bëj një përmbledhje
10 të gabimeve juridike dhe vlerësimit të dëshmive, në veçanti,
11 sa i takon përdorimit të deklaratave të z. Shala, gjë e cila
12 është në shkelje të plotë të të drejtave të tij. Do mbuloj
13 pikat 6 deri 11 të dosjes të Mbrojtjes të cilat kanë të bëjnë
14 me gabime të ngjashme dhe jo më pak problematike lidhur me
15 trajtimin që i ka bërë Trupi Gjykses provave të dëshmitarëve
16 të këtë lëndë gjyqësore.

17 Më lejoni së pari të fillojë me pikën 6. Ne parashtrojmë
18 që Trupi Gjykses ka bërë gabime të rënda në vlerësimin dhe
19 pranimin e besueshmërisë së tre dëshmitarëve kryesorë të
20 Prokurorisë, i cili bën pavlefshëm të gjitha vendimet e
21 fajësisë dhe që kanë çuar në mospërmbushje të drejtësisë. Këto
22 gabime janë bërë duke aplikuar ose duke zbatuar standardeve të
23 dyfishta në vlerësimin e dëshmive shfajësuese dhe
24 inkriminuese, kanë shkelur parimin e *in dubio pro reo*, dhe
25 kanë përbërë abuzim ose keqpërdorim të diskrecionit të Trupit

1 Gjykues.

2 Asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do të kishte
3 arritur në përfundimin që ka arritur Trupi Gjykues në
4 aktgjykimin e vet, dhe kjo është shkaktuar jo vetëm si
5 rezultat i gabimeve të vlerësimit të provave që kanë rezultuar
6 si rezultatet i keqpërdorimit të diskrecioneve të tyre, por
7 gjithashtu edhe si rezultat i gabimeve të zbatimit të ligjeve
8 kur kanë trajtuar provat, precedencën dhe peshën që i kanë
9 dhënë këtyre provave në totalin e dëshmive dhe provave të
10 administruara.

11 Për shkak të kufizimeve kohore do doja që të përmend dy
12 shembuj kryesorë për secilin prej tre dëshmitarëve në këtë
13 çështjeje. Do filloj së pari me Dëshmitarin e Prokurorisë 01.

14 Asnjë gjykues i arsyeshëm fakti do arrinte në përfundimin
15 që të gjitha faktet që rrethojnë praninë e këtij dëshmitari si
16 përpara mbërritjes së tij dhe pas largimit të tij në Kukës,
17 nuk kanë rëndësi materiale për akuzat dhe nuk janë relevante
18 për sa i takon besueshmërisë së dëshmitarit. Kjo merr dhe më
19 tepër peshë në kontekstin në cilin ky dëshmitar ka mbërritur
20 dhe është larguar nga Kukësi dhe kjo është dëshmia e
21 demonstruar e pambësueshmërisë e dëshmisë së tij dhe mungesa e
22 besueshmërisë së narrativës ose historisë së tij kur bëhet
23 fjalë lidhur me kush ka bërë çfarë, për çfarë arsye, kur ka
24 ndodhur kjo gjë ose gjatë caktuar, dhe në çfarë rrethanash
25 kanë ndodhur situatat e paraqitura prej tij.

1 Kur çështja ka të bëjë me ekzagjerimin ose me zmadhimin e
2 fakteve dhe implikimin e personave si mënyrë hakmarrje ndaj
3 tyre ose ndaj institucioneve hetuese, asnjë gjykues faktesh
4 nuk do t'i linte mënjanë elementë të tillë vendimtarë në
5 besueshmërinë -- në vlerësimin e besueshmërisë. Këto gabime,
6 ne parashtrojmë, janë të mundur kur Trupi Gjykues ka vendosur,
7 për shembull, që mund të korrigjonte, le të themi, datën e
8 mbërritjes së dëshmitarit në Shqipëri, që është testuar dhe
9 diskredituar, të nderuar Gjykatës, përmes elementëve objektivë
10 gjatë seancave, gjatë kundërpyetjeve thjesht duke dhënë
11 precedencë në dëshmi të tjera të cilat nuk kanë qenë të
12 verifikuara dhe kanë ardhur nga deklaratat të dëshmitarëve që
13 kanë vdekur. Të nderuar Gjykatës, këtu dua t'ju referoj tek
14 paragrafët 377 deri në 379 e aktgjykimit si dhe dua t'ju
15 referoj gjithashtu edhe në provën DPS00124. Do ju lutesha
16 gjithashtu që të shikonit 1610, 1515 të transkriptit.

17 Të njëjtat lloje gabimesh mund të përmenden gjithashtu
18 për dëshmitë që kanë të bëjnë me rrethanat e lirimit, dhe të
19 njëjtat dëshmi nuk mund të merren parasysh në mënyrë të
20 arsyeshme nga një gjykues faktesh si jomateriale dhe si
21 jorelevante për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmisë së një
22 dëshmitari. Për sa i takon shembullit të dytë lidhur me këtë
23 dëshmitarë, të nderuar Gjykatës, do ju lutesha të kalonim
24 shkurtimisht në seancë private.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Të lutem,

1 Sekretar, të kalojmë në seancë private.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.
11 Faleminderit.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

13 Pra, për të përfunduar me këtë shembull të dytë, të
14 nderuar Gjykatës, asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do
15 të besonte në një dëshmi të tillë e cila vendos Pjetër Shalën
16 në vendngjarje ku fakti i vërtetuar i mangësisë së kësaj prove
17 është vendosja e njerëzve në vende dhe ngjarje dhe
18 vendngjarje.

19 Duke u kthyer Dëshmitarit, tani, W04733, ka të bëjë ose
20 me dy shembuj që kanë të bëjnë me identifikimin dhe
21 mbështetjen.

22 Së pari, identifikimi. Asnjë gjykues i arsyeshëm i
23 fakteve do të pranonte identifikimin e bërë nga ky dëshmitar,
24 identifikimi i z. Shala, ndërkohë që përshkrimi i bërë është
25 ai i një personi me lëkurë të errët, pothuajse i zi. Jo vetëm

1 që aktgjykimi e pranon këtë përshkrim dhe mbështetet në të për
2 të shpallur Pjetër Shalën fajtor, por edhe e justifikon atë
3 duke arritur në përfundimin dhe po citoj, "paraqitja e jashtme
4 mund, ndryshon me kohën dhe kujtesa e dëshmitarit mund të ketë
5 ndikuar nga kalimi i kohës".

6 Të nderuar Gjykatës, shikoheni Pjetër Shalën. Ju lutem
7 shikoheni lëkurën, ngjyrën e lëkurës së tij. A është e
8 arsyeshme të mendohet që kjo mund të ketë ndryshuar me kalimin
9 e kohës? Asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do të arrinte
10 në këtë përfundim, të nderuar Gjykatës.

11 Dhe meqenëse në këtë pjesë përmendet kalimi i kohës,
12 Mbrojtja parashtron se ky element është një nga temat kyçe ku
13 standardi i dyfishtë është bërë i qartë gjatë gjithë në të
14 gjithë aktgjykimin. Ky kalim kohe që justifikoi dëshmitarin e
15 Prokurorisë që ta përshkruajë një mashkull të bardhë si të zi,
16 është i njëjti kalim kohe që nuk justifikoi dëshmitarin a
17 paaftësinë dëshmitarit të Mbrojtjes për të vendosur në FMK një
18 tualet të cilin ai mund ta ketë përdorur ose jo para 25 vitesh
19 apo që të jepte numrin e saktë, vendndodhjen e saktë të
20 kamionit ose kamionëve në oborrin ku ai ka qenë para 35
21 vitesh.

22 Sa prej nesh mund të kujtojnë hollësi të tilla të
23 ndërtesave të shkollës apo të universitetit?

24 Të nderuar Gjykatës, është ky standard i dyfishtë në
25 trajtimin e materialeve shfajësuese apo shfajësuese që kanë

1 bërë të mundur këto gabime në dhe këto përfundime të
2 paarsyeshme.

3 Shembulli i dytë është Dëshmitari 04733. Asnjë gjykues i
4 arsyeshëm i fakteve nuk arrin në përfundimin që dëshmia e një
5 pjesëtari të familjes është mbështetëse e dëshmisë së
6 Dëshmitarit 04733. Në fakt, kjo provon të kundërtën e
7 historisë së tij në pothuajse çdo aspekt të saj. Dëshmitari i
8 Prokurorisë 06, numër 06, tha që Dëshmitari 4733 ka thirrur,
9 ka telefonuar 06 nga fabrika e metalit në vitin 1999, në
10 telefon, për t'i thënë atij që ishte mirë. Ju referoj, të
11 nderuar Gjykatës, transkriptin faqja 808.

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]. Dhe kjo gjendet në
15 faqet 648 dhe 752 të transkriptit.

16 Dëshmitari i Prokurorisë 09 tha që ata e zbuluan emrin e
17 Pjetër Shalës pas luftës, në vitin 2000 dhe kjo dhe se
18 Dëshmitari 04733 nuk e dinte kush ishte Pjetër Shala. Nuk ka,
19 nuk është çudi që ai e përshkruan atë si të si të errët,
20 ngjyrë të errët apo thujse të zi.

21 Dëshmitari 04 tha gjithashtu që ky mashkull, burrë që ata
22 zbuluan të jetë Pjetër Shala vinte nga Kroacia. Dhe kjo
23 gjendet në faqen 1007 të transkriptit.

24 Dëshmitari 4733 pretendoi se Dëshmitari i Prokurorisë 06
25 i tha atij se ky person ishte në 1998 para shtëpisë së tyre me

1 djalin e tij, djalin e tij pra, që pretendohej të ishte djali
2 i Pjetër Shalës. Kjo gjendet në dëshminë 082892, provën
3 materiale, -TR-ET Pjesa 1 RED3, faqja 36. Ky fakt
4 kundërshtohet nga Dëshmitari i Prokurorisë 06 në faqet 857
5 deri në 858 të transkriptit dhe nuk është në përputhje me
6 personin, nuk përputhet me personin që është Pjetër Shala.

7 Asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do të arrinte në
8 përfundimin që kjo është, kjo përbën mbështetje.

9 Dhe, në fund, Dëshmitari i tretë, 1448. Trupi Gjykues
10 gaboi, bëri gabim faktik dhe ligjor në vlerësimin e dëshmisë
11 së Dëshmitarit 1448 duke mos marrë parasysh elementë kyç që
12 kanë të bëjnë me identifikimin e gabuar që ai ka bërë të
13 Pjetër Shalës, si dhe edhe këtu zbatuar standard të dyfishtë
14 në vlerësimin e dëshmimeve të të njëjtës natyrë varësisht nëse
15 bëhej fjalë për prova të natyrës fajësuese ose shfajësuese.

16 Edhe këtu do të jap dy shembuj për të listuar këtë gjë.

17 Së parim, Dëshmitari 1448 kishte identifikuar në mënyrë
18 të gabuar z. Shala në një grup fotografish, në një procedurë
19 identifikimi grup fotografish dhe identifikimi bazohej në
20 informacione që i ishin dhënë atij nga dëshmitari, nga një
21 dëshmitar. Do t'i kthehem kësaj pak më në hollësi në seancë
22 private.

23 Trupi Gjykues konstatoi dhe po citoj "fakti që Dëshmitari
24 1448 identifikoi një individ tjetër si z. Shala në mes të
25 fotografive të paraqitura, ku në fakt asnjëra prej tyre nuk

1 përmbante z. Shala nuk ka asnjë ndikim në konstatimin e Trupit
2 Gjykues". Kjo gjendet në paragrafin 713 të aktgjykimit. Asnjë
3 gjykues i arsyeshëm i fakteve do të kishte arritur në një
4 përfundim të tillë.

5 Ne parashtrojmë se Trupi Gjykues gaboi kur nuk mori
6 parasysh pasojat e identifikimit të gabuar të z. Shala nga ky
7 dëshmitar si dhe burimin e njohurisë që ky dëshmitar kishte
8 për Pjetër Shalën.

9 Dhe kjo më çon tek pika e dytë lidhur me këtë dëshmitar,
10 që ndërlihet me pikën e parë dhe që duhet të trajtohet në
11 seancë private, të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Mund të
13 kalojmë në seancë private, ju lutem.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë
3 publike. Faleminderit.

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.
5 Faleminderit, Gjykatës. Tani, duke kaluar tek pika 7, që ka të
6 bëjë me padisponueshmërinë e dëshmitarëve dhe mbështetja e
7 gjerë dhe vendimtare në prova të patestuara në aktgjykim.

8 Ne kemi shpjeguar në dosjen tonë sesi gabimet e bëra në
9 aktgjykim zhvlerësojnë të gjitha shpalljet, dënimet të cilat
10 janë, që kanë rezultuar në keqadministrim të drejtësisë. Në
11 thelb, prapë, Trupi Gjykses bëri gabim ligjor dhe faktik kur
12 mohoi kërkesën e Mbrojtjes që dëshmitarët e Prokurorisë 02 dhe
13 04 të marrin pjesë në seancë dhe të merren në pyetje nga pala
14 e kundërt sepse ata ishin të gjallë dhe të disponueshëm dhe
15 ishin të vetmit që ishin në gjendje që të jepnin dëshmi lidhur
16 me tema konkrete dhoma e ndalimit 2 dhe aspektet e tjera kyçe
17 siç ishte ndryshimi i rojeve pas vdekjes së viktimës së
18 vrasjes.

19 Pas këtij mohimi, Trupi Gjykses e trajtoi dëmin që i
20 ishte shkaktuar Mbrojtjes duke u mbështetur në deklaratat e
21 tyre me shkrim të paverifikuara në shkallë të gjerë,
22 ndonjëherë disa herë duke diskretituar dhe tregimet e një
23 dëshmitari bazuar në tregimin e dëshmitarit tjetër dhe arriti
24 në konstatime të kundërta për z. Shala, të dëmshme këto për z.
25 Shala për çështje që për të cilat dëshmitarët kishin

1 informacion shfajësues në tërësi.

2 Siç është shpjeguar në hollësi në dosjen tonë në
3 paragrafin 115, 143, Trupi Gjykues arriti në përfundimin se
4 përgjegjësia penale individuale e z. Shala përmes NKP-së për
5 krimet e për të cilat akuzohet në bazë të shtatë konstatimeve
6 kyçe gjendet në paragrafin 1025 të aktgjykimit. Nga këto
7 shtatë konstatime, katër prej tyre bazohen vetëm ose në një
8 shkallë të gjerë në dëshmi të paverifikuara dhe disa prej tyre
9 nuk kanë të bëjnë me vdekjen apo padispueshmërinë e
10 dëshmitarëve në fjalë por kanë të bëjnë me vendimet e vetë
11 Trupit Gjykues për të mos i dëgjuar ato në Gjykatë.

12 Znj. Cariolou do t'i trajtojë këto pika, kur duhet
13 trajtuar pikën 8 dhe 11.

14 Tani kthehem tek pika 8 dhe 11, që kanë të bëjnë me
15 vendosjen për të marrë parasysh deduktimet e pabazuara dhe të
16 pajustificuara. Trupi Gjykues jo vetëm që ka nxjerrë
17 përfundime të cilat nuk ishin deduktimet e vetme të mundshme
18 dhe që mund të nxirreshin nga dëshmitë në dispozicion, sipas
19 neve, Trupi Gjykues ka pas një qasje dhe më problematike kur e
20 ka bërë deduktime aty ku nuk mund të nxirreshin deduktime të
21 tilla sepse provat, për shembull, në mënyrë të thjeshtë dhe të
22 drejtpërdrejtë mohojnë faktin apo nuk e trajtojnë fare atë
23 fakt apo në rastet kur thjesht nuk kishte prova për atë fakt
24 të caktuar.

25 Kjo është bërë edhe në vlerësimin e vetë të deklaratave

1 të z. Shala, ashtu siç e tha më herët z. Gilissen në
2 parashtrimet tona.

3 Kjo ka ndodhur edhe për sa i përket konstatimeve të
4 kontrollit lidhur me kontrollin gjyqësor apo informacionin për
5 arsyet e arrestit dhe konstatimet lidhur me akuzimet për
6 bashkëpunim dhe më në përgjithësi të planit të përbashkët,
7 qëllimit të planit të përbashkët.

8 Këto deduktime janë shoqëruar me analogji dhe krahasime
9 të rrezikshme ku një qasje kazuistike ishte e detyrueshme.
10 Mungesa e informacionit apo arsyet për arsyet e ndalimit të
11 një viktime ishte bëhej baza për të deduktuar nga Trupi
12 Gjykues për të deduktuar që mungesa e kësaj gjëje për një
13 viktimë tjetër. Rrethanat e lirimit të pavarur të një viktime
14 ishte, u bë baza për të deduktuar se lirimi i të tjerëve nuk
15 kishte rezultuar, nuk kishte dalë nga një proces i duhur nga
16 vendimi i një autoriteti kompetent. Kjo ka përfshirë viktimat
17 që janë përmendur në aktakuzë, nuk janë diskutuar gjatë
18 gjykimit dhe për të cilat nuk është dhënë arsye lidhur me
19 elementët e procesit të duhur gjyqësor dhe garancitë
20 procedurale apo marrjen në pyetje.

21 Kjo është një pikë e cila do të trajtohet nga znj.
22 Cariolou në përgjigjet e pyetjeve tuaja. Por thjesht për të
23 përfunduar me këtë pikë, Mbrojtja parashtron se deduktimet e
24 pajustificuara të papërligjura të Trupit Gjykues kanë luajtur
25 një rol të madh në konstatimet në aktgjykimin e Trupit Gjykues

1 që përbën bazën për shpalljen fajtor për të gjitha z. Shala
2 është akuzuar.

3 Tani, të nderuar Gjykatës, do të përfundoj me
4 parashtrimet e mia me pikën 10 dhe duke konstatuar kontrastin
5 drastik të qasjes që i është rezervuar dëshmitarëve të
6 Mbrojtjes dhe më në përgjithësi provave shfajësuese në
7 aktgjykim ku krahasohet kjo me trajtimin që i është rezervuar
8 materialeve akuzuese apo fajësuese.

9 Trupi Gjykses ka abuzuar autoritetin në kompetencë të tij
10 diskrecionale kur ka, duke peshuar disa nga -- duke marrë
11 parasysh apo vlerësuar provat kyçe të Mbrojtjes.

12 Nuk kemi shumë kohë, por do të përmend një shembull, do
13 t'i përmendem dëshmisë së Dëshmitarit 06, z. Bardhyl Mahmuti i
14 cili u thirr nga Mbrojtja e z. Shala për të trajtuar në mënyrë
15 konkrete pretendimin e bërë nga Dëshmitari 4733 se z. Mahmuti
16 ishte në Kukës që ka marrë pjesë në marrjen në pyetje dhe
17 keqtrajtimin, si edhe Mbrojtja si dëshmi e pretendimit të
18 Mbrojtjes së 04733 ka vendosur disa emra dhe personalitete
19 përfshirë dhe fqinjët e tij dhe e ka bërë këtë në mënyrë të
20 rreme me qëllim që t'i implikonte ata në mënyrë të gabuar.

21 Z. Mahmuti ka marrë pjesë në këtë gjykim dhe dha
22 pasaportën e tij për kohën në fjalë kur ka qenë refugjat,
23 bashkë me provat që ai ka qenë në Shqipëri në atë kohë, por ka
24 qenë në gjithë Evropën në përpjekje për të mbledhur, për të
25 gjetur mbështetje për çlirimin e Kosovës, mbështetje politike

1 dhe diplomatike. Kjo provë, që ishte pika kyçe kryesore
2 thelbësore e dëshmisë së z. Mahmuti dhe arsyeja për të cilën
3 ai erdhi në Hagë për të dhënë dëshmi, u hodh poshtë nga Trupi
4 Gjykues në aktgjykimin e tij pa e trajtuar atë në asnjë prej
5 përfundimeve të aktgjykimit. Në vend të kësaj deklaroj se
6 qëndrimet politike personale të z. Mahmuti lidhur me Dhomat e
7 Specializuara si institucion tregojnë se ai është i anshëm dhe
8 ka tendencë të gënjejë me qëllim që të mbrojë Pjetër Shalën
9 dhe, si rezultat i kësaj, ai u vlerësua si tërësisht i
10 pabesueshëm.

11 Në këtë gjykim, të nderuar Gjykatës, në këtë aktgjykim,
12 [REDAKTUAR] e një dëshmitari [REDAKTUAR]
13 [REDAKTUAR] nuk është tregues i një mundësie për të gënjyer
14 për të njëjtat fakte dhe e njëjta provë kur është e shoqëruar
15 bashkë edhe me kërcënime brenda sallës së gjyqit ndaj të
16 akuzuarit dhe familjes së tij, ndërsa postimi në *Facebook* i
17 një personi politik që po jep mendimet e tija personale që ai
18 mendon, që janë bazuar në punën e tij dhe shkrimet e tij, që
19 janë pikëpamje intelektuale dhe akademike, këto qenkan tregues
20 të mundësisë për të gënjyer, për të fshehur apo për të
21 mbuluar dhe mbrojtur të akuzuarin nga përgjegjësia e tij.

22 Kjo është një prej shumë shembujve që tregojnë standardin
23 e dyfishtë, të nderuar Gjykatës, që rezultojnë me gabime
24 ligjore dhe faktike të zhvilluara dhe të trajtuara në pikat 6,
25 11 të dosjes sonë.

1 Dhe pa marr më shumë kohë do t'ia kaloj fjalën znj.

2 Cariolou për të zhvilluar pikat e tjera.

3 Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim]

5 Faleminderit shumë.

6 Fjalën e keni ju, znj. Cariolou.

7 ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

8 Jam e vetëdijshme për kohën, do të jem sa më e shkurtër që të
9 jetë e mundur dhe të trajtoj pyetjet e Trupit Gjykues, do të
10 më duhet pak më shumë se 20 minuta për ta bërë këtë.

11 Së pari do të jap një përgjigje të shkurtër të pyetjes së
12 parë të Panelit dhe pastaj do të shtjelloj përgjigjen për
13 pjesën tjetër. Referencat për provat dhe autoritete janë dhënë
14 me shkrim dhe anëtarët e Trupit Gjykues mund t'i përcjellin
15 parashtimet tona lidhur me këtë pikë.

16 Sa i takon dëshmisë gojore që ka të bëjë me dy
17 konstatimet e identifikuara nga Peneli, ne do të kufizojmë
18 përgjigjen tonë duke deklaruar se sa i takon periudhës pas 5
19 qershorit, Trupi Gjykues konstatoi se rojet e reja u
20 zëvendësuan aty dhe kushtet e ndalimit u përmirësuan. Mbrojtja
21 nuk e kundërshtojë këtë konstatim. Sidoqoftë konstatimi
22 mbështetet nga dëshmia gojore e Dëshmitarit 01 si dhe dëshmia
23 me shkrim e 1448 dhe 04.

24 Siç e kemi thënë në dosjen tonë, ky konstatim është i
25 rëndësishëm për çështjen e Mbrojtjen e z. Shala sepse po

1 kundërshton në mënyrë të drejtpërdrejtë konstatimin se vdekja
2 e Trupit Gjykues se viktima e vdekjes -- se vdekja e viktimës
3 së vdekjes ishte bërë me marrëveshje nga ata që
4 konsideroheshin si të pranishëm në fabrikën e metalit.

5 Sa t'i kthehem pyetjes së dytë. Neve na është kërkuar të
6 japim, të shtjellojmë në parashtrimet tona dhe t'i zhvillojmë
7 ato lidhur me burimin e të drejtës mbi të cilën është
8 mbështetur si autoritet dhe për kritere që kanë të bëjnë me
9 garancitë procedurale mbi të cilat konsiderohen nga Trupi
10 Gjykues si elementë të krimit të ndalimit arbitrar.

11 Sipas mendimit, Trupi Gjykues ka ndërtuar kritere të reja
12 si element të krimit të ndalimit arbitrar në një konflikt të
13 armatosur jo ndërkombëtar dhe duke bërë këtë ka transfuzuar
14 garancitë procedurale qoftë nga e drejta që zbatohet në
15 konfliktet e armatosura ndërkombëtare apo e drejta për e
16 përgjithshme për të drejtat e njeriut. Duke bërë këtë, nuk
17 është mbështetur në autoritetin bashkëkohor dhe detyrues që
18 nga viti 1999. Së pari, duke bërë këtë, ka shkelur parimin e
19 ligjshmërisë duke mos respektuar parimin e së drejtës penale
20 që duket të përkufizohet me siguri dhe në çdo kohë duket të
21 zbatohet në kohën e kryerjes së krimit.

22 Së pari, Trupi Gjykues është mbështetur në Kryqin e Kuq,
23 në studim të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar të vitit 2005.
24 Megjithatë, ky studim mbështetet në parimet që kanë të bëjnë
25 me konfliktet e armatosura ndërkombëtare apo në të drejtën e

1 përgjithshme për të drejtat e njeriut. Ajo që ky studim bën të
2 qartë është nevoja për një arsye të vlefshme për privimin apo
3 heqjen e lirisë si arsye fillestare për arrestimin si dhe për
4 vazhdimin e heqjes së lirisë. Kjo nuk e shtjellon më tej
5 garancitë procedura që duhet të vendosen nga entitete jo
6 shtetërore kur individë të caktuar mbahen të ndaluar për arsye
7 të sigurisë.

8 Në rastin tonë, ka prova të bollshme që sugjerojnë që
9 arsyeja fillestare për privimin, heqjen e lirisë ishte hetimi
10 për arsye të sigurisë dhe, në veçanti, bashkëpunimi i dyshuar
11 me forcat armike serbe. Ka prova se gjithë të ndaluarit u
12 morën në pyetje lidhur me pretendime konkrete dhe specifike.
13 Disa prej tyre dhe u liruan pas marrjes në pyetje.

14 Dhe pretendimet për keqtrajtim nuk mund të merren
15 parasysh në vlerësimin ose ndalimi si i tillë ishte i ligjshëm
16 apo arbitrar. Sa i takon referencave të së drejtës së
17 përgjithshme për të drejtat e njeriut, studimi që përmendëm më
18 herët, pranon se të dy kriteret në shqyrtim mund të ketë
19 përjashtime ndaj këtyre dy kriterëve. Shteti nënshkrues, për
20 rrjedhojë, në rast të rrethanave që kërcënojnë jetën e një
21 shteti mund të mos -- mund të shmang detyrimin e tij ndaj
22 këtyre për të siguruar detyrimin për të siguruar respektimin e
23 kriterëve specifike. Ky është element i rëndësishëm duhet për
24 t'u marrë parasysh në vlerësimin e së drejtës për ndalim
25 arbitrar siç është zbatuar ë vitin 1999 në një konflikt të

1 armatosur jo ndërkombëtar. Në veçanti --

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] A mund të
3 ndaloni, të ngadalësoni pak ritmin sepse po shkon shumë
4 shpejt.

5 ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Çështja *Lawless* kundër Irlandës
6 të cilës Paneli i vlerësohet nuk është relevant sepse ka të
7 bëjë me detyrimet e konventave të shtetit kontraktues si
8 përgjigje ndaj aktiviteteve ndaj një ushtrie sekrete dhe
9 rritjes së vazhdueshme të terrorizmit.

10 Mbështetja e Trupit Gjygues në Nenin 75(4) të Protokollit
11 Shtesë 1 të Konventave të Gjenevës nuk ndihmon. Zbatimi i
12 protokollit të parë kufizohet në konfliktet e armatosura
13 ndërkombëtare apo në rastin e pushtimit të një territori të
14 një pale kontraktuese të lartë.

15 Tani, megjithëse Protokolli Shtesë II zbatohet në
16 konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare, referencat të
17 Panelit në këtë nen është e pavend. Në mënyrë të qartë, kjo
18 dispozitë, ka të bëjë siç thuhet dhe në titull, për përndjekje
19 penale kriminale. Ajo që provat e Prokurorisë paraqesin që ka
20 ndodhur në fabrikën e metalit në Kukës nuk ka të bëjë fare me
21 gjykimin në zhvillim apo që të përfunduara. Provat e
22 Prokurorisë përshkruajnë ndalimin e individëve të caktuar si
23 pjesë e hetimit për dyshime që këta mund të paraqesin rrezik
24 sigurie.

25 Referenca mbi të cilën mbështete Trupi Gjygues dhe po

1 citoj, "Gjykatë që ofron garanci thelbësore të pavarësisë dhe
2 paanësisë merret nga një detyrim komplet ndryshe që imponohet
3 nga Neni 6 i cili parasheh se nuk do të zbatohet asnjë
4 ndëshkim, përveç se në rast se personi shpallet fajtor nga një
5 gjykatë që ofron garanci të tilla thelbësore.

6 Sidoqoftë Prokuroria thotë që këta persona janë ndaluar
7 dhe janë marrë në pyetje mbi dyshime se ishin rrezik sigurie.
8 As nuk dolën para një gjykate. As nuk u dënuan. Dhe as nuk
9 morën një dënim.

10 Parimisht ndalimi i një personi për qëllime të një hetimi
11 nuk mund të konsiderohet i paligjshëm për sa kohë ka arsye të
12 vlefshme për arrestimin dhe vazhdimin e paraburgimit. Çka do
13 të thotë, për sa kohë se ka dyshim të arsyeshëm se ky person
14 është një kërcënim për sigurinë. Ndalime të tilla nuk mund të
15 konsiderohen të paligjshme në mënyrë të pafundme, po, po
16 kohëzgjatja e paraburgimit të çdo të ndaluari nuk ka qenë
17 asnjë arsye e paraqitur në analizën, a u bë ndonjë analizë e
18 tillë në goftë se ishte apo jo arbitrar ndalim.

19 Ajo që mungon në analizën e Trupit Gjykues është një
20 vlerësim i shtjelluar i provave, që do të thotë se ka pasur
21 dyshime se çdo i ndaluar ishte kërcënim për sigurinë dhe nëse
22 një dyshim të tillë mund të konsiderohet i arsyeshëm në atë
23 kohë. Pra, ky është standardi mbi të cilin duhet të ishte
24 bazuar analiza e tyre. Por të rrëzosh provat që sugjerojnë se
25 ekziston një dyshim i tillë apo mund të konsiderohej i

1 arsyeshëm, sipas nesh, ka qenë gabim dhe në këtë rast duhet të
2 kishte ndërhyrë Apeli.

3 Kjo në çon në pyetjen e dytë që ka ngritur Gjykatësi
4 lidhur me konstatimet e Trupit Gjykues në thonjëza që " asnjë
5 shqetësim sigurie nuk e bën absolutisht të domosdoshëm
6 ndalimin". Dhe unë dua të flas këtu për standardin më të lartë
7 që ka zbatuar Trupi Gjykues për këtë. Duhet të ekzistojnë
8 shqetësime sigurie që e bëjnë ndalimin absolutisht të
9 domosdoshëm. Me gjithë respekt, ky është standard i gabuar.

10 Provat ku është mbështetur Trupi Gjykues tregonin se të
11 ndaluarit ishin marrë në pyetje për arsye, pra, për dyshime
12 konkrete për sa i takon marrëdhëniet që kishin me forcat
13 armike. Osman Kryeziu dhe Sokol Dobruna janë përshkruar në
14 prova si Prokurorë apo Gjykatës hetues që i kanë bërë këto
15 pyetjet dhe kanë marrë deklaratat me shkrim prej këtyre të
16 ndaluarve.

17 Me lejen tuaj do të doja të kalonim në seancë private.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Po. Në
19 rregull. Kalojmë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Për të përfunduar me këtë

1 pyetje, dokumentet e procesverbalit gjyqësor nuk i lejoi
2 konstatimet që nxori Trupi Gjykses, sidomos kur u bë fjalë për
3 standardin e provës që duhet të ishte zbatuar.

4 Kalojmë tani tek pyetja e tretë e Panelit. Kryerja e
5 krimit të luftës së vrasjes së paligjshme kërkon që të ketë
6 pasur synim për të vrarë. Në rastin tonë, synimi për të vrarë
7 viktimën e vrasjes apo synimi për të dëmtuar rëndë viktimën
8 apo synimi për të mos i dhënë qëllimisht kujdes shëndetësor
9 viktimës edhe për këtë kryesi duhet ta kishte ditur përpara se
10 të ndodhte vdekja e personit.

11 Jurisprudenca shpjegon kjo:

12 "Mens rea e vrasjes përfshin si synimin e drejtpërdrejtë
13 ... që është synimi i kryesit i cili e dëshiron vdekjen e
14 personit dhe kërkon që kjo të jetë pasojë e veprimit apo
15 mosveprimit të tij dhe synimi i tërthortë ... që është
16 njohuria nga ana e kryesit ... se vdekja do të ishte një
17 pasojë e veprimit apo mos veprimit të tij."

18 Por themi pasojë e mundshme.

19 Ju lutem shikoni paragrafin 448 të aktgjykimit të
20 Karadzic edhe referencat që janë përdorur ku janë përfshirë
21 Oric, Djordjevic, Popovic, Mulutinovic dhe Lukic, aktgjykimet
22 përkatëse të këtyre personave.

23 Tani, sipas formës së parë të përgjegjësisë penale të
24 NKP-së, çdo pjesëmarrës në NKP-në në fjalë duhet të ndajë mens
25 rea, pra, synimin për qëllimin kriminal të rënë dakord të NKP-

1 së. *Mens rea* për krimin e synuar në fjalë duhet të jetë i
2 njëjti për secilin pjesëmarrës. Përgjegjësia penale sipas
3 formës së parë të ndërmarrjes kriminale është përgjegjësia
4 penale si kryesi parësor. Secili kryes duhet të ketë marrë
5 pjesë me vullnet të plotë në një ndërmarrje kriminale të
6 përbashkët, të kenë pasur të njëjtin synim dhe këtë synim ta
7 kenë ndarë me pjesëmarrësit e tjerë. Në rastin tonë, synimi
8 për të vrarë një person, synimi për ta vrarë viktimën e
9 vrasjes së paligjshme apo për ta lënduar qëllimisht për të
10 shkaktuar vdekjen e tij apo për të mos i dhënë kujdes
11 shëndetësor që mund t'i kishe shpëtuar vdekjen. Por duke pasur
12 synimin e qartë që kjo do të shkaktonte vdekjen e personit,
13 synimi i secilit pjesëmarrës duhet të ishte i barabartë me atë
14 të tjerëve të tjerë dhe vetëm në këtë formë kjo formë e
15 përgjegjësisë penale i atribuon secilit pjesëmarrës barrë të
16 njëjtë përgjegjësie penale për veprën penale në fjalë.

17 Sipas nesh, nuk lejohet ta deduktosh synimin bazuar në
18 prezumimin se z. Shala e synonte vdekjen e këtij personi apo
19 se e kishte paraparë se pasoja e tij do të ishte vdekja. Një
20 Gjykatës duhet të ndajë synimin dhe sigurojë se përmbushë
21 standardin e kërkuar dhe të jetë i barasvlershëm me synimin e
22 kryesve të tjerë parësor.

23 Kundërshtimi ynë i parë që kemi ne lidhur me këtë pikë
24 është se ka cenuar të drejtën e z. Shala për gjykim të drejtë
25 dhe prezumimin e pafajësisë duke mosshpjeguar në konstatimet e

1 veta çfarë synimi kishte z. Shala lidhur me veprimet dhe
2 mosveprimet e z. Shala dhe si përputhen këto me atë që
3 shkaktoi vdekjen e personit.

4 Arsyetimi i Trupit Gjykues dhe atribuomi i synimit duket
5 sikur është një atribuomë automatik i synimit që në fakt cenon
6 Nenin 6 dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Lidhur me këtë
7 ju lutem shihni gjykimet e Strazburgut rastin *Goktepe* kundër
8 Belgjikës dhe Delespesse kundër *Belgium* dhe Haxhishabani
9 kundër *Luxembourg* për akuzat si në vijim: atribuomi automatik
10 i përgjegjësisë penale për të gjithë pjesëmarrësit në një
11 ndërmarrje të përbashkët cenon Nenin 6 kur në krye të një
12 vlerësimi të kujdesshëm i synimit të tyre subjektiv dhe
13 individual edhe barrës së përgjegjësisë përkuese të secilit
14 person.

15 Tani, gabimi i konstatimit të Trupit Gjykues përmes *mens*
16 *rea* për vrasjen është në fakt në bazë të konstatimeve të veta
17 për shkaktimin e vdekjes. Sipas Trupit Gjykues një person që
18 nuk është në fakt z. Shala ka qëlluar me armë zjarri viktimën
19 më 4 qershor në këmbë. Plumbi goditi, kapi venën kryesore që
20 shkaktoi hemorragji dhe kjo shkaktoi hemorragji dhe kjo është
21 konfirmuar dhe nga Dr. Gasior i Prokurorisë dhe kjo shkaktoi
22 më pas, hemorragjia shkaktoi vdekjen e viktimës së vrasjes së
23 paligjshme. Veç kësaj, veç dëmtimit të rëndë që shkaktoi
24 plumbi, një anëtar i UÇK-së, që prapë nuk ishte z. Shala, nuk
25 lejoi transferimin e viktimës në spital në mënyrë që të merrte

1 kujdesin shëndetësor. Kjo pavarësisht faktit që doktori e
2 kishte bërë të qartë që personi nuk do të mbijetojë nëse nuk
3 merr kujdesin e nevojshëm shëndetësor.

4 Shkaku i vdekjes sipas Trupit Gjykues është ky:

5 "... Trupi Gjykues del në përfundimin se Viktima e
6 Vrasjes së Paligjshme vdiq nga pasojat nga gjuajtja me armë
7 zjarri në këmbën e tij e kombinuar kjo me mohimin e kujdesit
8 shëndetësor, mosdhënien e kujdesit shëndetësor."

9 Z. Shala nuk përmendet në konstatimet që përshkruajnë
10 shkakun e vdekjes. Vdekja, na tha Trupi Gjykues, u shkaktua
11 nga personi që e qëlloi me armë zjarri, goditi arterien
12 kryesore dhe personit nuk iu ofrua kujdes shëndetësor. Çdo
13 synim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë për vrasje lidhet me
14 këta dy persona. Z. Shala edhe në provat e Prokurorisë nuk
15 thuhet gjëkund që e ka shkelur këmbëzën, nuk e gjuajti
16 personin, nuk ia mohoi kujdesin shëndetësor viktimës. Pra,
17 ndonëse personi që e qëlloi këtë viktimën në këmbë kishte
18 synim për të vrarë as kjo nuk është e qartë. Të qëllosh dikë
19 në këmbë shënon synimin për ta lënduar një person, mbase për
20 ta kufizuar lirinë e tij në një farë forme. Por nuk tregon
21 domosdoshmërisht synim për ta vrarë një person. Personi që nuk
22 i dha kujdesin shëndetësor, mbase ka ditur që viktima do të
23 mbijetonte pa marrë kujdesin shëndetësor, po nuk e dimë a
24 kishte synim apo jo për ta vrarë personin. Megjithatë a ndanim
25 të njëjtin qëllim me personin që e qëlloi? A ndante të njëjtin

1 qëllim me personat që ishin të pranishëm kur ndodhi kjo?

2 Provat e Prokurorisë tregojnë se më së paku një person
3 tjetër, në mos më shumë, kanë kërkuar që t'i ofrohet kujdesi
4 shëndetësor. Sipas provave të Prokurorisë është bërë një
5 përpjekje që t'i ndalohej hemorragjia personit me çfarëdo që
6 të kishin në atë moment në fabrikë. Të paktën disa persona,
7 pra, kanë pasur për synim ta ndalonin gjakderdhjen dhe ta
8 shpëtonin viktimën e vrasjes së paligjshme.

9 Prokuroria ka treguar po ashtu se menjëherë pas vdekjes,
10 rojet u ndërruan dhe u bë një përmirësim drastik në kushtet e
11 ndalimit për të garantuar që të mos përsëritej më një rast i
12 tillë. Ajo që ne nuk dimë, për shkak të arsyetimit të vagullt
13 të Trupit Gjykues është se çfarë përfundimi kanë nxjerrë ata
14 lidhur me synimin e z. Shala në atë kohë. Edhe vetë Prokuroria
15 nuk ka bërë të qartë nëse e ka ditur z. Shala që do të
16 qëllohej viktima e vrasjes së paligjshme. [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR], por nuk po përmend detajet se jemi
19 në seancë të hapur. Po është e paqartë a ka qenë ai në dijeni
20 dhe a mund ta parashikonte ai se në qoftë se do të qëllohej ky
21 person nuk do të merrte kujdesin shëndetësor dhe do ta linin
22 të vdiste?

23 Të dënosh z. Shala për vrasje të paligjshme duhej të
24 vërtetohej nga Trupi Gjykues se z. Shala synonte ta vriste
25 viktimën. Mbrojtja konteston për arsyet që kemi bërë të qartë

1 në dosjen tonë se z. Shala ka qenë i pranishëm gjatë kësaj
2 kohe. Edhe në rast se e marrim për të mirëqenë, ne e gjykojmë
3 që Trupi Gjykses ka gabuar kur konstatoi se vetë z. Shala
4 kishte synim ta vriste, se vetë Shala ka ndarë ekzaktësisht të
5 njëjtin synim për të vrarë si personi që e qëllloi atë dhe si
6 personi që nuk i ofroi kujdesin shëndetësor. Prandaj, nuk
7 është e drejtë, sipas nesh, që z. Shala të ndajë të njëjtën
8 barrë apo përgjegjësi penale për vrasje.

9 Tani do të flas për pyetjen e fundit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Mikrofoni
11 çaktivizuar].

12 [Përkthim] Bëjmë një pushim për hir të përkthyesve.

13 Mund t'ua kërkoj përkthyesve në fakt nëse doni që ta
14 bëjmë pushimin apo të vazhdojmë?

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
16 këshillohen]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Keni dhe
18 dhjetë minuta, ju lutem, për të përfunduar atëherë.

19 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Më pak se kaq do të kem nevojë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Pesë
21 minuta? Në rregull. Pesë minuta.

22 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Pra, pyetja e fundit e Panelit.

23 Në kohën e kryerjes së veprës penale, ligji në fuqi, siç
24 është pranuar nga Trupi Gjykses, kishte dhënë dënimet
25 përkatëse. Asnjë dënim më i lehtë nuk u mor parasysh sipas të

1 drejtës së Kosovës. Mosdhënia e një dënimi që është paraparë
2 me ligj që zbatohet në kohën e kryerjes së veprës penale është
3 cenim i së drejtës së z. Shala sipas Nenit 7 të Konventës.

4 Kjo, sipas nesh, nuk ndryshohet nga aktgjykimi i Gjykatës
5 kushtetuese në rastin Mustafa.

6 Neni 7 thotë:

7 "Nuk duhet dhënë një dënim më i rëndë penal që të jetë i
8 ndryshëm nga dënimi që do të jepej në kohën kur ka ndodhur
9 vepra penale."

10 Kur Paneli të interpretojë aktgjykimin e Gjykatës
11 Kushtetuese duhet ta bëni këtë duke marrë parasysh kriteret e
12 Nenit 7 të Konventës, që është një normë që ka epërsi, sipas
13 nesh.

14 Gjithashtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm me këtë.
15 Nëse marrim parasysh faktin se llojet e dënimeve të 1999 mund
16 të mos jenë detyruese, atëherë mbase do jemi duke bërë një
17 gabim edhe më themelor duke thënë se nuk ka pasur asnjë ligj
18 asokohe për të dënuar personin për krimet që ka kryer z. Shala
19 në kohën kur kanë ndodhur këto krime. Dënimi që i është dhënë
20 z. Shala buron atëherë vetëm nga dënimi që është prezantuar në
21 mënyrë retroaktive nga ligjet e DHSK-së çka çon në një cenim
22 edhe më të madh të parimit të ligjshmërisë.

23 Ka dhe një kriter shtesë të Nenit 7 që do të thotë ligji
24 parasheh edhe veprën penale, dënimi për këtë vepër penale
25 thotë që duhet të jetë e qartë. Jo që nuk është, jo vetëm që

1 është e qartë sot, në mënyrë retroaktive, po ka qenë e qartë
2 dhe në 1999 kur ka ndodhur vepra penale në fjalë dhe ka qenë e
3 paraparë për kryesin asokohe.

4 Sipas nesh, komunikimi mes Trupit Gjykues, Apelit,
5 Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Supreme, tregojnë pikërisht
6 faktin që ka mungesë qartësie në cilësinë e ligjeve që cenojnë
7 apo asaj që ka ndodhur që cenojnë Nenin 7.

8 Z. Gilissen në fakt ka një parashtrim të fundit për
9 çështjen e dënimit.

10 Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Bëjmë tani
12 pushimin atëherë dhe kthehemi në orën 4.00 pa dhjetë, në 3.50.

13 --- Seanca ndërpritet në orën 15.21

14 --- Seanca rifillon në orën 15.53

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirë se u
16 kthyet.

17 Përpara sesa t'i jap fjalën avokatit nga ZPS-ja,
18 Prokurorit të ZPS-së, e kuptoj që z. Shala kërkon që të na
19 drejtohet për 25 minuta të tjera, në qoftë se nuk e kam
20 gabuar. z. Gilissen, pra përfaqësuesi i z. Shala, ju kërkon
21 dhe 25 minuta tjera? nëse nuk gaboj apo jo?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, kështu është.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.
24 Ne e shqyrtuam kërkesën e z. Gilissen, dhe do ju japim dhjetë
25 minuta për të përfunduar, në qoftë se është e mundur, z.

1 Gilissen.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do përpiqemi.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.
4 Faleminderit shumë. E keni ju fjalën tani.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit znj.
6 Kryegjykatëse, të nderuar anëtarë të Panelet të Apelit. Është
7 gjithmonë shumë e vështirë që të argumentosh dënimin kur
8 argumenti ynë është për shqiptim të pafajësisë. Megjithatë ky
9 nuk është argumenti ynë sot. Ne këtu po diskutojmë mënyrën se
10 si aktgjykimi, i cili tani është në nivel apeli, është
11 shpallur -- dënimin për z. Shala dhe e ka dënuar atë më 18
12 vjet heqje lirie.

13 Ju e keni arsyetimin me shkrim të paraqitura nga
14 Mbrojtja, kështu që besoj që të gjitha dokumentet sa i takon
15 argumentimit tonë është përpara jush. Por, qëllimi ynë këtu
16 është që të japim parashtrime me shkrim dhe këto parashtrime
17 me shkrim do t'i kufizojmë në tri aspekte të argumenteve të
18 zhvilluara në këto dokumente.

19 Dëshiroj të theksoj tri elementë konkretë në aktgjykim që
20 sipas mendimit tonë përbëjnë lloje të rënda të gabimeve të
21 cilat, ose të marra së bashku ose më vete, e bëjnë të
22 pavlefshme procesin që ka çuar në dënimin e z. Shala.

23 Mbrojtja e z. Shala është absolutisht e vetëdijshme që
24 ndonjëherë dënimi është padyshim një prej aspekteve më
25 komplekse të praktikës gjyqësore. Ky është një proces i cili

1 kërkon ca teknikalitet dhe ne e dimë se sa e vështirë është që
2 të kërlesh bazën ligjore të nevojshme për të mbështetur
3 vendimin e dënimit, dhe aq më tepër bëhet më e komplikuar
4 situata kur bëhet fjalë për çështje ndërkombëtare.

5 Sipas Mbrojtjes, gabimi i parë i bërë nga Trupi Gjykses
6 në aktgjykim gjendet që në fazën e parë, dhe sipas nesh ky
7 gabim bën të pavlefshëm dënimin në aktgjykim. Mbrojtja e z.
8 Shala konstaton se aktgjykimi ka gabuar për sa i takon
9 përzgjedhjes së saj si ligj të zbatueshëm, por gjithashtu edhe
10 sa i takon përzgjedhjes së dënimit, sikurse u shpjegua dhe pak
11 më herët nga znj. Carioliu.

12 Më duhet të them që zbatimi i parimit të ligjshmërisë
13 është shumë i rëndësishëm për Trupin Gjykses në mënyrë të
14 tillë që të merren edhe parasysh edhe dispozitat ligjore të së
15 drejtës së Kosovës, përfshirë këtu, për shembull, cila është
16 gama e dënimit për veprat e pretenduara, që sipas
17 legjislacionit të Kosovës është maksimumi 15 vite burgim për
18 krime lufte kundër popullatës civile.

19 Po ashtu rikujtoj që z. Shala është dënuar 18 vjet burgim
20 për krime të cilat janë pjesë e krimeve kundër popullatës
21 civile.

22 Ndërkohë, gabimi i dytë që dëshirojmë të sjellim në
23 vëmendje ka të bëjë me shkeljen e një prej parimeve themelore
24 që kanë të bëjnë me dënimin, e kam fjalën konkretisht për
25 parimin që garanton cilësinë në procesin e dënimit dhe që një

1 dënim nuk është përtej kufijve të arsyeshëm dhe është në
2 përputhje me dënimet e dhëna në çështje të tjera të lidhura
3 dhe të krahasueshme.

4 Ne mund të themi pa bërë gabim që në këtë rast, pra në
5 rastin konkret, ne kemi tre precedentë konkretë të cilët
6 konstatohen si shumë të rëndësishme sa i takon udhëzimit për
7 dënimin dhe që sigurojnë proporcionalitetin kur krahasohen me
8 çështje shumë të rënda përkatësisht, për shembull, çështjen që
9 kanë përfshirë z. Geci, z. Krasniqi dhe së fundi z. Mustafa.

10 Sikurse e dini z. Geci dhe z. Krasniqi janë dënuar për
11 krime lufte të kryera ndaj popullatës civile. Këto janë krime
12 të cilat janë kryer në vitin 1999 në Kukës, në Shqipëri, në
13 atë çfarë Prokurori i Specializuar e konsiderohen se është i
14 njëjti kontekst si në akuzat e ngritura ndaj z. Shala.
15 Megjithatë këta dy persona janë dënuar nga një juridiksion
16 ndërkombëtar në Kosovë për disa krime dhe fakte kriminale edhe
17 pse këta dy persona janë konsideruar që kanë qenë persona me
18 autoritet ose kompetencë në vend në fabrikën e metalit në
19 Kukës. Ato po ashtu janë konsideruar si personat që kanë
20 organizuar arrestimin, ndalimin dhe trajtimin për të
21 parandaluarit -- për të paraburgosurit, përfshirë edhe
22 intervistat dhe marrjen në pyetje.

23 Duhet të theksohet gjithashtu që është gjykuar që këta dy
24 persona janë persona të cilët kanë projektuar dhe kanë zbatuar
25 të gjithë organizimin në faktorë -- në fabrikën e metalit në

1 Kukës që ka lejuar për krimet që të ndodhin atje.

2 Pra, natyra, në cilësi dhe në sasi, të përfshirjes së
3 këtyre dy personave është në nivelin më të rëndësishëm ose më
4 të lartë të mundshëm. Presumohet, dhe besoj që çdokush
5 pajtohet me këtë pikë, që e gjithë kjo si dhe ndalimi dhe
6 intervistat, kanë filluar përpara sesa z. Shala të ketë
7 mbërritur në Shqipëri në vitin 1999 dhe sigurisht përpara sesa
8 ai të dërgohej në Kukës. Kështu që në çdo rast të gjitha -- e
9 gjithë situata në fabrikën e metalit në Kukës ka filluar dhe
10 ka vazhduar dhe është bërë pa asnjë përfshirje të z. Shala.
11 Edhe në qoftë se ju do konsideroni se z. Shala ka marrë pjesë
12 në ndonjë akt kriminal pas mbërritjes në Kukës, gjë të cilën
13 ai e mohon kategorikisht, kjo do të thotë që përfshirja e tij
14 e pretenduar jo domosdoshmërisht ka qenë në lidhje me
15 funksionimin e organizimit ose organizatës, por që një
16 organizim i tillë është prezantuar pa qenë ai i pranishëm.

17 Dhe, në fakt, ashtu siç thotë dhe Prokuroria organizimi
18 në vend ka filluar pa të, pra pa z. Shala, dhe ka vazhduar dhe
19 ka funksionuar edhe pasi është larguar z. Shala nga fabrika e
20 metalit në Kukës. Kështu që funksionimi i organizatës që ka
21 qenë në atë kohë padiskutim ose me siguri nuk ka pasur nevojë
22 për të, për të funksionuar.

23 Z. Geci është dënuar me 15 vjet për krime të kryera jo
24 vetëm në Kukës po ashtu edhe në Cahan.

25 Ndërkohë që z. Krasniqi është dënuar me shtatë vjet,

1 ndërkohë në rastin e z. Shala, sikurse e dini ai është dënuar
2 me 18.

3 Kështu që mund të them me siguri që aktgjykimi nuk ka
4 arritur që të sigurojë barazi në dënim. Në të nuk jepet peshim
5 i duhur dhe nuk bëhet një krahasim i duhur me dënime të tjera
6 në raste të lidhura ose krahasueshme.

7 Askush sot nuk pretendon që z. Shala ka qëlluar ose ka
8 qenë personi i cili ka shtënë në drejtim të viktimës në 5
9 qershor 1999, megjithatë ai prapë është personi i cili është i
10 vetmi person që është deklaruar fajtor dhe është dënuar për
11 një krim që nuk e ka kryer. Trupi Gjykues ka konsideruar që z.
12 Krasniqi, i cili është shpallur i pafajshëm, që ka qenë
13 personi përgjegjës për këtë vrasje. Megjithatë pavarësisht
14 kësaj për shkak të efektit të pabesueshëm të NKP-së, z. Shala
15 rrezikon që të jetë personi i vetëm që është dënuar dhe ka
16 marrë dënim fajësie për një vrasje që ai nuk e ka kryer.

17 Çfarë ironie. Çfarë situatë ironike, ku ti je shumë i
18 ashpër dhe zbaton standardeve tërësisht të ndryshme për të
19 njëjtat grupe faktesh. Pra, situata si mund të jetë kaq e
20 ndryshme në Mitrovicën dhe në Hagë.

21 Jo vetëm kaq, por në aktgjykim nuk jepet një opinion i
22 arsyetuar lidhur me faktin se pse Trupi Gjykues ka marrë një
23 vendim dënimi që është kaq shumë i ndryshëm lidhur -- sa i
24 takon krahasimit të kësaj çështje me çështjen kundër z. Geci
25 dhe z. Krasniqi. Ky është një tjetër gabim juridik. Të gjitha

1 këto pika janë absolutisht shumë të rëndësishme që pse
2 Mbrojtja konsideron drejtësinë e dënimit dhe drejtësinë e
3 procesit gjyqësor, që sipas nesh janë të shkelura të dyja në
4 çështjen kundër z. Shala.

5 Ne i referohemi dhe çështjes Mustafa. Ju e dini që ky
6 është një tjetër vendim interesant, sepse është një vendim i
7 cili është nxjerrë nga një Trup Gjykues i Dhomave të
8 Specializuara të Kosovës. Z. Mustafa është dënuar 26 vjet
9 heqje lirie, por pas apelit, dënimi i tij është ulur në 15
10 vjet.

11 Në qoftë se çështja e Mustafës duket e ngjashme në ligj
12 më atë të z. Shala, më duhet të them që ka të paktën një
13 dallim kryesor lidhur me të dyja situatat përkatëse të këtyre
14 dy individëve padyshim në pozicionet që të kanë pasur ata dhe
15 autoritetin që kanë pasur ata. Domethënë në qoftë se do të
16 shikojmë autoritetin e z. Mustafa ai është tërësisht i
17 ndryshëm nga ai i z. Shala.

18 Më tepër sesa 20 vite hetimesh askush nuk ka pretenduar
19 që të ketë qenë nën urdhra ose nën udhëzimet e z. Shala apo që
20 është varur nga z. Shala. E kundërta është e vërtetë, pra
21 mbështetur në dëshmitarin më të rëndësishëm të Prokurorisë që
22 është Dëshmitari 1, z. Shala ka vepruar vetëm nën kontroll, në
23 urdhrat dhe në udhëzimet dhe personave që janë identifikuar si
24 epror dhe si dhe personat përgjegjës për qendrën e ndalimit
25 dhe funksionimin e kësaj qendre ndalimi në fabrikën e metalit

1 në Kukës.

2 Duke marrë parasysh praninë dhe përmbajtjen e një vendimi
3 të tillë, veçanërisht në çështje të ngjashme, dhe në çështjet
4 specifike që kanë të bëjnë me krimet e kryera në Kukës,
5 Mbrojtja e z. Shala ka këto konstatime: Aktgjykimi që apelohe
6 sot e ka dënuar padrejtësisht dhe pa vend z. Shala. Dënimi
7 është joproporcional sikurse e thamë dhe më tepër, është dënim
8 i pajustificuar dhe i tepërt dhe nuk është i krahasueshëm me
9 atë që janë dhënë për z. Geci, z. Krasniqi ose z. Mustafa në
10 gjykimet e tyre.

11 Në qoftë se Trupi Gjykses arrin në përfundimin që nuk
12 është i detyruar që të respektojë dënimet e dhëna nga gjykatat
13 e brendshme ose gjykata të tjera ndërkombëtare, duket se
14 aktgjykimi i nxjerrë nga Trupi Gjykses mundohet që të shkojë
15 përtej kufijve diskrecionalë të Trupit Gjykses dhe kufizohet
16 në vendosjen e një dënimi joproporcional.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Dhjetë
18 minutëshi juaj mbaroi, z. Gilissen. Ju kërkoj ndjesë që ju
19 ndërpres. Nuk e di nëse keni shumë gjëra të tjera për të thënë
20 apo jo.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, po e shkurtoja ndërkohë,
22 ndërkohë që po flisja.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po
24 përfunduat tani?

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kam përfunduar akoma, por

1 thjesht doja t'ju them që po e shkurtoj pjesën e fundit të
2 prezantimit tim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Thjesht dua
4 t'ju them që këto që po thoni tani i kemi lexuar dhe në dosjen
5 tuaj. Sigurisht që keni të drejtën që të shpreheni deri në
6 fund, po do ju kërkoja, nëse është e mundur, që të jeni me
7 konciz ose në qoftë se mund të jeni më i shpejtë. Ju lutem,
8 përfundoni sa më shpejt të mundemi.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. E vlerësoj shumë kohën.

10 Kjo ishte pika e parë që doja të shtjelloja përpara jush,
11 të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues. Pra, mendoj që është
12 shumë e rëndësishme që të individualizohet dënimi sepse mendoj
13 që kjo është mënyra më e mirë për të prezantuar aftësinë për
14 ta bërë dënimin të prekshëm, "njerëzor" apo për të përfshirë
15 edhe elementë të tjerë njerëzorë në një dënim, sepse në fund
16 të ditës po dënon një person jo një send, jo një çështje, jo
17 një zjarr.

18 Sigurisht një person është i përbërë nga një grup
19 kompleks rrethanash, përvojash është e të tjerë.

20 Sikurse e dini, z. Shala kanë qenë në Kosovë deri gjatë
21 luftës, derisa filloi lufta. Pra të gjithë jetën e vet ai ka
22 vuajtur nga segregacionet ose nga veçimi si dhe nga shtypja e
23 dhunshme e shtetit serb. Ai ka jetuar në një jetë të
24 përditshme me presion të tillë, pra nën një forcë, pra, forcat
25 serbe të cilat e kanë detyruar popullatën shqiptare që të

1 humbte punët e veta dhe gjithashtu dhe të mos fliste shqip. E
2 ka detyruar për të mos folur shqip. Dhe ky ka qenë krimi i
3 vetëm, në fakt, i z. Shala që të mos fliste -- ai nuk duhet të
4 fliste shqip. Pra krimi i tij ishte që ka jetuar dhe ka lindur
5 nga një familje shqiptare.

6 Ju mund të keni ndjesinë tuaj se takon z. Shala,
7 megjithatë dua t'ju them unë këtë gjë, kini parasysh që ky
8 burrë ka qenë vetë viktimë, ka qenë viktimë e policisë -- e
9 policimit të një shteti kundër popullatës civile.

10 Dua që të përqendrohem pak në këtë kontekst sepse mendoj
11 që është shumë e rëndësishme që të kuptohet se si të trajtohet
12 një situatë e tillë. Të nderuar Gjykatës, si mendoni ju, a nuk
13 mendoni ju që një policim i tillë kriminal dhe i dhunshëm ka
14 formësuar popullatat civile. Si e mendoni ju, të nderuar
15 Gjykatës, një dhunim i tillë sistematik i personave të tillë i
16 identiteteve të tyre, nuk mendoni se kanë pasur ndonjë ndikim
17 mbi jetën e tyre dhe çfarë mendoni ju që ka pasur kjo mbi
18 aspektet psikologjike afatgjata të këtyre personave?

19 Atëherë sa i takon kësaj pike juve do sanksiononi dhe do
20 ndryshoni, besoj, aktgjykimin që tani ne po e apelojmë, sepse
21 sipas parashtrimit tonë ekzistojnë disa rrethana të
22 rëndësishme lehtësuese në favor të z. Shala.

23 Së fundi, duhet të mbajmë parasysh që kalimi i kohës dhe
24 pasojat e saj, nuk janë marrë fare parasysh gjatë vendimit të
25 dënimit nga Trupi Gjykses. Ne mendojmë që ky është gabim

1 juridik. Në fakt, mosha na lejon që dënimin ta japim duke
2 reflektuar këtë realitet dhe kini parasysh që z. Shala ka
3 filluar një jetë të reja në Belgjikë. Është distancuar nga çdo
4 grup kriminal ose çdo aktivitet kriminal, ky është rasti i z.
5 Shala.

6 Dhe së fundi, së dyti, më duhet që të vlerësoj dhe --
7 duhet të flas edhe për vlerësimin për sa i takon kohës së
8 arsyeshme, pra sipas parashtrimit tonë në qoftë se tejkalohet
9 koha e arsyeshme në një proces gjyqësor kjo ka pasoja ligjore.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Duhet të
11 përfundoni tani, z. Gilissen.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Përfundova.

13 Dhe ne mendojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme që
14 të korrigjohet ky gabim juridik.

15 Më lejoni të them dhe një gjë të fundit. Jemi besimplotë
16 që ju këtë aspekt do ta merrni parasysh duke ndryshuar
17 aktgjykimin dhe duke nxjerrë dhe bërë të ditur procesin ligjor
18 për sa i takon dënimit.

19 Siç më thatë ka ardhur koha për ta përmbyllur. Dhe në
20 përfundim më lejoni të them që gabimeve që përmendëm gjatë
21 gjithë procesit, duhet në tërësinë e tyre ose veçmas të kenë
22 pasojat në vendimin e marrë prej jush. Unë jam besimplotë që
23 drejtësia do të vihet në vend dhe pasojat e këtyre gabimeve do
24 të pasqyrohen tek rezultati fundor i vendimmarrjes tuaj.

25 Shumë faleminderit për vëmendjen.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

2 Faleminderit për përpjekjet. Faleminderit për parashtrimin.

3 Tani do t'i kërkoja Prokurorit që të vazhdojë me
4 përgjigjen e tij. Keni kohë në dispozicion deri në orën 5.30.

5 Në qoftë se do keni nevojë për më tepër kohë, kemi ende
6 nesër kohë për të vazhduar.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirdita, të nderuar Gjykatës.
8 Mirëdita, të gjithëve të pranishmëve në sallë.

9 Znj. Clanton dhe unë do të trajtojmë kryesisht pyetje që
10 na ka drejtuar Trupi Gjykses sot pasdite. Unë do të trajtoj
11 pyetjet të cilat kanë të bëjnë me pikat 7 dhe 13, ndërkohë që
12 kolegia ime do të trajtojë pika që ka të bëjë me pikat 12 dhe
13 14 të dosjes së Mbrojtjes.

14 Përpara kësaj dëshiroj do të dëshiroj të bëj disa komente
15 të përgjithshme. Dëgjuam parashtrimet e bëra nga Mbrojtja dhe
16 i konsiderojmë këto parashtrime që janë përsëritje të
17 parashtrimeve të bëra në dosjen e apelit dhe në fakt ne i jemi
18 përgjigjur dosjes së apelit në përgjigjen tonë. Me përjashtim
19 të disa komenteve që ne do të bëjmë tani, ne duam që t'i
20 trajtojmë -- nuk duam që t'i trajtojmë këto parashtrime më tej
21 me përjashtim të rasteve kur ju, të nderuar anëtarë të Trupit
22 Gjykses, mund të keni pyetje për ne.

23 Z. Shala, apeluesi, është konstatuar fajtor për tre
24 akuza, për akuzën e ndalimit, torturave dhe vrasjes pas një
25 procesi të drejtë gjyqësor. Në mënyrë të padiskutueshme provat

1 e pranuar në këtë çështje gjyqësore kanë vërtetuar që ai ka
2 qenë i pranishëm në fabrikën e Kukësit gjatë kohës së
3 aktakuzës dhe që personalisht ka marrë pjesë me brutalitet dhe
4 ashpërsi të paparë në ndalimin dhe torturimin e të burgosurve.
5 Po ashtu, provat e administruara në këtë proces gjyqësor kanë
6 vërtetuar që ai ka marrë pjesë në vrasjen e viktimës së
7 vrasjes së paligjshme. Prova nuk lë asnjë dyshim që ai i ka
8 kryer të gjitha këto krime, siç kërkohet nga parimi *mes rea*.

9 Trupi Gjykses ka arritur në këtë përfundim pasi ka
10 dëgjuar 33 dëshmitarë gjithsej, mbi 500 prova materiale, 22
11 prej të cilëve kanë ardhur këtu për të dhënë dëshmitë e tyre
12 përpara Trupit Gjykses, përfshirë këtu dhe viktima dhe persona
13 të cilët kanë qenë të pranishëm në fabrikën e metalit në
14 Kukës. Sikurse është e qartë në aktgjykim, Trupi Gjykses ka
15 kryer një proces gjykimi dhe vlerësimi të kujdesshëm, të plotë
16 dhe transparent.

17 Nuk ka pasur anësi, nuk ka pasur standarde të dyfishta
18 ose narrativa të preferuara. Trupi Gjykses ka treguar gjykim
19 të shëndoshë dhe gjithashtu edhe pragmatizëm sa i takon
20 vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve, duke marrë
21 parasysh faktorë të tillë si, për shembull, konfirmimin,
22 anësinë, motive të tjera apo sjelljen e tyre në Gjykatë.

23 Dëshmitarët e Prokurorisë kanë dhënë dëshmi koherente dhe
24 konsistente për sa i takon ndalimit në fabrikë dhe pranisë së
25 z. Shala dhe rolit të tij. Dëshmitë e tyre kanë qenë

1 konfirmuese të njëra-tjetrës. Ato të gjitha kanë dëshmuar që
2 ka pasur persona të ndaluar në atë vend. Personat që kanë qenë
3 të pafat që të hasen dhe të merren me z Shala e kanë thënë të
4 qartë në dëshminë e tyre se çfarë roli ka pasur ai, dhe këtë
5 rol ata e kanë përshkruar në mënyrë të qartë dhe konsistente
6 përpara Trupit Gjykues.

7 Po ashtu disa prej -- nga ana tjetër, dëshmitarë të
8 Mbrojtjes kanë dhënë dëshmi selektive dhe jobindëse kur kanë
9 dhënë dëshmi nën betim përpara Trupit Gjykues. Një rast që nuk
10 e përmendi Mbrojtja, nuk ka të bëjë me vendin e ndodhjes së
11 një tualeti ose pozicionin e një kamioni, por ka të bëjë me
12 ekzistencën e një godine të tërë, një godine ku kanë qenë të
13 ndaluar viktimat në këtë çështje gjyqësore.

14 Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi të shumë dëshmitarëve të
15 cilët janë mbajtur të ndaluar në godinën e ndalimit dhe në
16 fabrikën e metalit në Kukës. Këto dëshmitarë si dhe dëshmi
17 fotografike të fabrikës së metalit në Kukës tregojnë që kjo
18 godinë ose ndërtesë kanë qenë mu në mes të fabrikës së metalit
19 në Kukës. Domethënë në mes fare të kopshtit ose të oborrit,
20 siç mund të gjendet ky informacion shumë qartazi në paragrafët
21 316 dhe 318 të aktgjykimit.

22 Do ju thoja anëtarëve të Trupit Gjykues që të shikonit
23 faqen 1 të provës materiale P17. Është gjurma e një dokumenti
24 në origjinal, pra, është skica e fabrikës së metalit në Kukës.
25 Godina e ndalimit, sikurse pasqyrohet në paragrafët 316, në

1 aktgjykim gjendej në ndërtesat e pasqyruar në numrat 2 dhe 4
2 të gjurmës së ndërtesës. Dokumenti në të vërtetë tregon se ku
3 gjendej fizikisht kjo ndërtesë. Dhe Dëshmitarët e Mbrojtjes
4 4289, 3887, 4754 dhe Dëshmitari 5 i Mbrojtjes kanë qëndruar
5 aty, pra në këtë pjesë të godinës, dhe ky ka qenë vendi ku
6 janë keqtrajtuar edhe janë ndaluar personat dhe ku është vrarë
7 dhe viktima e vrasjes së paligjshme.

8 Ndërkohë Dëshmitarët 3887 dhe Dëshmitar 405 i Mbrojtjes
9 kanë punuar për muajt të tërë në këtë ndërtesë, pra në
10 Ndërtesën numër 4. Ndërtesa numër 4 është në të djathtë nga
11 ndërtesa e ndalimit e ndalimit. Kur futesh dhe del nga
12 ndërtesa ky është një pjesë të cilën e shikon lehtë. Dhe këta
13 janë personat të cilët kanë punuar natë e ditë ndërkohë që
14 kanë qenë atje.

15 Dhe kjo është një shembull që tregon që besueshmëria e
16 dëshmitarëve që është nxjerrë nga Trupi Gjykses nuk është
17 mbështetur në anësi ose standarde të dyfishta, por është
18 mbështetur në logjikë normale dhe në atë çfarë është mbledhur
19 si informacion nga dëshmitarët në Trupet Gjykesuese. Pra,
20 ndërkohë asnjë prej dëshmitarëve nuk ka thënë që nuk e mbajnë
21 mend një ndërtesë që gjendej mu në mes të oborrit. Ndërkohë,
22 për më shumë informacion, ju mund t'i referoheni paragrafit
23 316 të aktgjykimit.

24 Ky mohim është konsideruar më pas me -- marrë së bashku
25 me faktorë të ndryshme, për shembull, anshmëria dhe aspekte të

1 tjera të cilat neve do t'i diskutojmë më pas në parashtrimin
2 tonë.

3 Në të gjitha aspektet të mundshme procesi gjyqësor ka
4 qenë i drejtë, ka qenë në përputhje me ligjin, me rregulloret,
5 si edhe me standardet dhe ligjet e zbatueshme për të drejtat e
6 njeriut. Mbrojtja harxhoi kohë të konsiderueshme duke
7 argumentuar çështjen e deklaratave. Ne në fakt, çështjen e
8 deklaratave e kemi trajtuar dhe në përgjigjen tonë edhe në
9 diskutime të shumta si përpara Trupit Gjykses ashtu edhe
10 përpara Panelit të Apelit.

11 Në mënyrë të ngjashme, ne kemi trajtuar çështjen e disa
12 viktimave të cilat janë përmendur në aktakuzë, po gjithashtu
13 edhe vlerësimin e dëshmisë dhe besueshmërinë e dëshmitarëve --
14 e një dëshmitari të vetëm. Megjithatë edhe gjatë procesit të
15 gjyimit, Mbrojtja ka vendosur që të vazhdojë që të injorojë
16 dëshminë dhe nga z. Shala në deklaratat e veta dhe Trupi
17 Gjykses me të drejtë ka thënë që vetëm thjesht është
18 mbështetur në këto dëshmi për konfirmim kur ka marrë vendimin
19 e vet.

20 Kur ju thotë që 4733 ka qenë i gabuar kur ka identifikuar
21 z. Shala ata lanë pa thënë, pra Mbrojtja la pa thënë që z.
22 Shala vetë e ka parë 4733 në fabrikën e metalit në Kukës.

23 Gjithsesi, domethënë, kjo është një çështje të cilën e
24 kemi trajtuar në dosjen tonë, megjithatë, në qoftë se keni
25 pyetje plotësuese mund t'jua themi këtë më vonë.

1 Megjithatë, kjo është fazë apelimi nuk është mundësi për
2 rishqyrtim dhe nuk është një çështje që i kërkon Panelit të
3 Apelit të pajtohet ose të mos pajtohet me konstatimet e Trupit
4 Gjykues. Në qoftë se nuk gjenden gabime në aktgjykim, ky Panel
5 duhet të rrëzojë apelin dhe duhet që ta lërë në fuqi në
6 tërësinë e vet vendimin e fajësisë dhe dënimin e Trupit
7 Gjykues.

8 Tani dua që të trajtoj çështjen që kanë të bëjë më
9 keqtrajtimin dhe ndalimin çnjerëzor, kushtet çnjerëzore,
10 ndalimin çnjerëzor, pas vdekjes së viktimës së vrasjes së
11 paligjshme.

12 Të nderuar Gjykatës, që në fillim fare dua t'ju rikujtoj
13 që z. Shala nuk është akuzuar dhe nuk është dënuar për asnjë
14 krim që ka ndodhur pas 5 qershorit, ditën domethënë që pas
15 ditës së vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme. Kjo
16 është e qartë në formulimin e aktakuzës, po gjithashtu është e
17 qartë edhe vendimmarrje ose në aktgjykimin që e konstatoi z.
18 Shala fajtor për ndalimin arbitrar, torturën dhe vrasjen e
19 paligjshme të kryer në periudhën nga 17 maji deri në 5 qershor
20 1999.

21 Pra, 5 qershori është data kufi e këtyre akuzave dhe
22 dëshmitë e paraqitura në gjykim duhet të përqendrohen në atë
23 çfarë kanë ndodhur më përpara kësaj date. Megjithatë, për t'ju
24 përgjigjur pyetjes tuaj, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues,
25 tregon që pavarësisht disa përmirësimeve të vogla në kushtet e

1 të ndaluarve, keqtrajtimi i tyre i vazhdueshëm dhe kolektiv ka
2 vazhduar më tej dhe pas datës 5 qershor. Dhe këtu i referohem,
3 për shembull, [REDAKTUAR]
4 [REDAKTUAR]
5 [REDAKTUAR]. Gjithashtu dua
6 që të theksoj edhe një herë tjetër kushtet shumë të këqija në
7 godinën e ndalimit dhe gjithashtu dhe mungesën e kujdesit
8 shëndetësor.

9 Të nderuar Gjykatës, pa diskutim që keqtrajtimi kolektiv
10 i të ndaluarve dhe trajtimi çnjerëzor i tyre ka vazhduar dhe
11 pas 5 qershorit, por z. Shala as nuk është akuzuar për çfarë
12 kanë ndodhur pastaj kësaj date dhe as nuk është dënuar nga
13 Trupi Gjykses lidhur me këtë. Megjithatë, në qoftë se keni
14 nevojë për më shumë shpjegime të tjera, mund t'ju japim
15 shpjegime me shkrim ose në qoftë se doni mund t'ju japim
16 shpjegime pas seancës. Në qoftë se nuk kemi ndonjë kërkesë
17 specifike lidhur me këtë pikë, do vazhdoj me aspektin e dytë
18 ose me Pikën 7.

19 Tani do të trajtoj dëshmitë gojore që mbështesin ndalimin
20 e katër individëve duke diskutuar paragrafët 133 deri në 136
21 të dosjes së Mbrojtjes, dosjes së apelit të Mbrojtjes.

22 Ju, të nderuar Gjykatës, pyetët: dënimi i -- Mbrojtja e
23 kundërshton dënimin e z. Shala për këto pika. Cilat janë
24 provat në dosjen e gjykitimit që mbështesin apo kundërshtojnë
25 pretendimin se këto katër individë janë mbajtur të ndaluar në

1 FMK, përpara datës 5 qershor.

2 Nuk besoj se Mbrojtja e ka trajtuar këtë pikë. Ne do ta
3 trajtojmë atë.

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [[REDAKTUAR] .

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR] .

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR] .

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR].

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR].

10 Dëshmitari 1 u pyet cilët të ndaluar ishin në Dhomën 1
11 kur ai u soll aty për herën e parë dhe besoj që --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Besoj që
13 duhet të kalojmë në seancë private ju lutem.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] A mund të
16 kalojmë në seancë private, ju lutem.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.
4 Faleminderit.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Siç është e qartë nga
6 paragrafin 87 i aktgjykimit, Trupi Gjykues ishte tërësisht i
7 vetëdijshëm për kufizimet që imponon ligji sa i takon
8 përdorimit të dëshmisë me shkrim dhe të drejtat -- dhe për të
9 drejtat e të akuzuarit kur bëhet fjalë për të drejtën e tij
10 për të ekzaminuar dhe verifikuar provat kundër tij. Dhe jo
11 vetëm që paragrafi 87 tregon që Trupi Gjykues ishte i
12 vetëdijshëm për këtë, por edhe siç është përmendur në
13 përgjigjen -- në dosjen e përgjigjes tonë lidhur me përgjigjen
14 për pikën 7, Trupi Gjykues trajtoi me shumë kujdes për t'u
15 siguruar që kur të mbështetet në provat e patesuara, të
16 paverifikuara, sidomos kur bëhet fjalë për veprimet dhe
17 sjelljet e të akuzuarit ai u mbështet gjithmonë në të, së
18 bashku me provat mbështetëse.

19 Pra, parimi bazë, themelor sipas Gjykatës Evropiane për
20 të Drejtat e Njeriut kur bëhet vlerësimi i pranimi të
21 dëshmive me shkrim, ishte në shkelje të të drejtave pretendimi
22 se kjo ishte në shkelje me të drejtat e të akuzuarit apo
23 formonte bazën e vetme apo kishte rol vendimtar për dënimin,
24 shpalljen fajtor të të akuzuarit. Për shembull, kemi një parim
25 të mirë të njohur dhe vendosur i cili që është rikonformuar në

1 çështjen Keskin kundër Holandës, në faqen 63. Asnjë prej
2 provave, për shembull, që nuk kishte të bënte me këta katër
3 dëshmitarë.

4 Asnjë prej provave me shkrim që ne kemi treguar nuk është
5 vlerësuar në mënyrë të ndarë, të veçuar. Nuk ka qenë
6 vendimtare në lidhje me konstatimet, sa i takon konstatimeve
7 të incidenteve të vetëm dhe ka qenë sigurisht -- nuk kanë qenë
8 vendimtare në përgjegjësinë e përgjithshme të Shalës, kur
9 bëhet fjalë për krimet e ndalimit arbitrar dhe të torturës.

10 Dhe ka dy elementë që duhet të merren parasysh këtu. Së
11 pari, elementi i mbështetjes i cili është treguar në aktgjykim
12 dhe theksuar në përgjigjen tonë ka qenë gjithmonë i pranishëm
13 edhe kjo gjendet në konstatimet e Trupit Gjykses. Së dyti,
14 kemi edhe parimin tjetër që është marrë parasysh dhe që është
15 i theksuar në mënyrë të drejtë në aktgjykimin e fundit të
16 Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

17 Parimi që është përcaktuar aty dhe konfirmuar është që
18 mbështetja në një provë të patestuar shkel të drejtat e të
19 pandehurit. Gjykata mund të shqyrtojë nëse i pandehuri ka
20 pasur mundësi të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, të
21 cilët janë viktima të të njëjtët krijimeve nga të të njëjtit
22 kryerës.

23 Tani, Mbrojtja ka qenë në gjendje që t'i marrë në pyetje
24 të dy dëshmitarët, 1 dhe Dëshmitarin 11 të cilët ishin -- u
25 mbajtën të ndaluar për ndoshta periudha më të gjatë kohore në

1 FMK dhe në të njëjtat kushte keqtrajimi. Trajtimet që
2 dëshmitarët parashtruan dhe përmenden me shkrim dhe dëshmuan
3 për to.

4 Për të përfunduar, Mbrojtja nuk ka vërtetuar dhe nuk ka
5 asnjë shkelje apo cenim të të drejtave të z. Shala për të
6 testuar apo verifikuar provat kundër tij. I kërkojmë Trupit
7 Gjykses që ta shqyrtojë këtë me kujdes dhe ju referoj, me
8 respekt, në mënyrë më të gjerësishme në përgjigjen -- në
9 dosjen e përgjigjes tonë për hollësi të mëtejshme lidhur me
10 secilin dëshmitar.

11 Kam përfunduar me parashtrimet e mia dhe do t'i jap
12 fjalën tani koleges time, përveçse nëse ju keni pyetje të
13 tjera shtesë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Nuk kemi
15 pyetje për momentin.

16 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mirëdita. Do t'i përgjigjem
17 pyetjes tani, pyetjes tuaj lidhur me pikën 12.

18 Pika e parë të cilës kolegu im iu përgjigj nga
19 perspektiva e tyre ka të bëjë me paragrafët 208, 209, 212 të
20 dosjes së apelit, që i referohet paragrafëve 942 dhe 943 të
21 aktgjykimit. Pyetja i dha Mbrojtjes mundësinë për të
22 kundërshtuar apo për të shpjeguar pse kanë thënë që disa
23 burime mbi të cilat Trupi Gjykses është mbështetur është --
24 kanë qenë të gabueshme -- por ka qenë gabim që të bëhet
25 kështu.

1 Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje ne kemi dëgjuar më herët
2 dhe asaj që kemi dëgjuar më herët qëndrimi jonë është që Trupi
3 Gjykues nuk ka bërë asnjë gabim juridik. Trupi Gjykues ka
4 pasur të drejtë të mbështetet në burimet e së drejtës apo
5 ligjore, të përmendura në paragrafë të aktgjykimit dhe
6 interpretimin e garancive procedurale themelore të dyta dhe të
7 treta.

8 Parashtrimi i Mbrojtjes në dosjen e tyre, në paragrafin
9 208 se Paneli i Trupit Gjykues thjesht iu referua udhëzimeve
10 institucionale është i pasaktë dhe keqinterpreton aktgjykimin.
11 Ju referojmë, të nderuar Gjykatës, në paragrafët 219 dhe 220
12 të përgjigjes sonë.

13 Trupi Gjykues u mbështet kryesisht në të drejtën zakon --
14 studimin e KNKK-së që ka të bëjë me konflikte të armatosura
15 jondërkombëtare, përveç -- përveç në shtim të udhëzimeve
16 bashkë me udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të
17 Bashkuara, Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e
18 Njeriut dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
19 Mbështetja në këtë studim është aprovuar nga Paneli i Apelit
20 në çështjen Thaçi, i cili konstatoi se studimi në fjalë i
21 referohet burimeve të ndryshme të së drejtës humanitare
22 ndërkombëtare dhe të ligjit zakonor dhe të drejtës zakonore
23 dhe kjo është në parashtrimin F30, paragrafi 99, Çështja 06
24 dhe gjendet gjithashtu në burimin origjinal, paragrafin 154,
25 F412.

1 Mbështetja në këtë burim nga Gjykatësi i Procedurës
2 Paraprake është vlerësuar nga -- marrë parasysh nga Paneli i
3 Apelit gjithashtu si mbështetje për përfundimet që Gjykatësi i
4 Procedurës Paraprake me të drejtë ka gjetur apo konstatimet që
5 ka bërë sepse ekziston një seri garancish minimale themelore
6 që burojnë nga e drejta humanitare ndërkombëtare që janë e
7 drejta ndërkombëtare zakonore në natyrë dhe që duhet të jepen
8 t'i bëhen të mundshme një personi që mbahet i ndaluar,
9 pavarësisht ligjshmërisë së ndalimit të tyre apo jo, dhe
10 pavarësisht natyrës jondërkombëtare apo ndërkombëtare të
11 konfliktit të armatosur, shkelja e së cilës përbëhen një
12 shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3.

13 Të nderuar Gjykatës, i referohem këtu vendimit, F30, 221
14 [Sipas përkthimit].

15 Nuk do t'ju ngarkoj shumë me këtë pikë. Kam vetëm një
16 koment tjetër për të bërë lidhur me këtë përfundim që -- dhe
17 që është që ky përfundim nuk bazohet vetëm në rishikimin apo e
18 së drejtës penale -- e së drejtës zakonore ndërkombëtare me
19 ndihmën e studimit të KNKK-së dhe komentare të ndryshme. Kjo
20 është gjithashtu në përputhje me jurisprudencën e Dhomës së
21 Apelit të TPNJ-së.

22 Në çështjen Prokurori kundër Karadzic, 11 dhjetor 2012
23 paragrafin 18, Dhoma konfirmoi se njëri prej qëllimeve
24 themelore të nenit të përbashkët 3 është që të sigurohet një
25 minimum -- mbrojtje minimale dhe absolute për të mbajtur të

1 ndaluar individë, qofshin ata luftëtarë apo jo dhe hodhi
2 poshtë interpretimin e artikullit 3 që mund t'i hiqte të
3 ndaluarve të drejtën për mbrojtje minimale.

4 Tani do të kaloj në pjesën e dytë të Pyetjes 12,
5 ZPS-ja kupton këtë pyetje -- kupton që kjo pyetje ka të
6 bëjë me trajtimin që i ka dhënë Trupi Gjykses, mënyra si Trupi
7 Gjykses ka trajtuar provat që mbështesin përfundimin e tij se
8 ndalimi në FMK, të ndaluarit në FMK, dhe ky ndalim -- ndalimi
9 i këtyre të ndaluarve ka qenë arbitrar dhe i paligjshëm sepse
10 nuk ka qenë absolutisht i nevojshëm, i domosdoshëm lidhur me
11 veprat penale apo çështjet, shqetësimet e sigurisë. Në
12 krahasim me këtë, përpara se të trajtoj provat, thjesht do të
13 kujtoj parimet ligjore të së drejtës që janë relevante lidhur
14 me vlerësimin e ndalimit pa bazë ligjore.

15 Së pari, si çështje paraprake dhe siç është shpjeguar në
16 aktgjykim në paragrafin 936, ka disa mënyra sipas të cilës
17 *actus reus* për ndalim arbitrar konstatohet, së pari, ndalimi
18 është pa bazë ligjore. Elementi *actus reus* përmbushet kur
19 ndalimi bëhet i paligjshëm nga mohimi i garancive procedurale
20 themelore.

21 Kjo është sepse mosrepektimi i parimeve të trajtimit
22 njerëzor e bën ndalimin të paligjshëm pavarësisht nëse ka bazë
23 ligjore për të apo jo. Kjo është konfirmuar nga Trupi Gjykses
24 në apelin, në Panelin e Apelit në çështjen Thaçi dhe vendimi
25 P30, 23 dhjetor 2021, dhe paragrafët -- në paragrafet 97, 99.

1 Gjithashtu është konfirmuar nga e drejta penale
2 ndërkombëtare, jurisprudenca e saj, përfshirë TPNJ-ja në
3 Delacic, e cila e bën të qartë që edhe në qoftë se ekzistojnë
4 arsye legjitime për të mbajtur të ndaluar -- ndalimi për të
5 ndaluar dikë, ndalimi bëhet i paligjshëm në mungesë të
6 sigurimit të garancive procedurale themelore.

7 Tani t'i kthehen parimeve ligjore për të vlerësuar
8 shqetësimet e sigurisë.

9 Trupi Gjykues konstatoi se privimi, heqja e lirisë është
10 pa bazë ligjore nëse ajo nuk justifikohet as nga procedurat
11 penale as nga bazat e arsyeshme për të besuar se shqetësimet e
12 sigurisë e bëjnë atë absolutisht të domosdoshme. Kjo përputhet
13 me standardet nga Mustafa, çështja Mustafa në paragrafin 647
14 të aktgjyimit, e cila mbështetet nga jurisprudenca e
15 gjykatave ndërkombëtare. Përmenda më herët çështjen Delacic.

16 Në aktgjykimin e Delacic në TPNJ, paragrafi 1134, Trupi
17 Gjykues arriti në përfundimin se "privimi, heqja e lirisë
18 është pa bazë ligjore kur një numër i madh civilësh mbahen të
19 ndaluar në një kamp edhe pse ekzistojnë -- edhe pse nuk ka
20 patur arsye serioze apo legjitime për të arritur në
21 përfundimin se ata dëmtojnë në mënyrë të rëndë sigurinë e të -
22 - e pushtetit ndalues, pra të atyre autoriteteve që i mban të
23 ndaluar".

24 Për të hequr lirinë apo për të privuar një person nga
25 liria, përfundimi si një individ përbën shqetësim të sigurisë,

1 duhet të jetë përfundim i arsyeshëm i mbështetur nga arsye
2 legjitime dhe serioze. Kjo është në - është e paraqitur qartë
3 në aktgjykimin Delacic paragrafët 576, 577.

4 Për më tepër shqetësimet e sigurisë në fjalë kanë të
5 bëjnë me -- duhet të jenë konkrete, specifike dhe të rënda. Do
6 të thotë që jo çdo shqetësim i pretenduar përbën, arrin pragun
7 apo përmbush kriterin që mundëson privimin nga liria. Ndërsa
8 ndërkohë që spiunazhi mund të përbëjë një shqetësim të rëndë
9 të sigurisë mbajtja -- pushteti -- autoriteti që mund të
10 ndalojë persona duhet të ketë arsye legjitime dhe serioze që
11 përbëjnë baza të arsyeshme për të besuar se pala që mban të
12 ndaluar personat është në rrezik.

13 Dhe për të përfunduar për të justifikuar përdorimin e
14 ndalimit të personave duhet, siç është konsideruar këtë gjë
15 dhe në rastin Delacic, autoriteti që mund të ndalojë personat
16 duhet të ketë arsye të mira për të menduar se individ i në
17 fjalë përmes aktiviteteve të tij a njohurisë apo aftësive të
18 tij përbën një kërcënim real ose përbën për sigurinë e
19 tanishme apo të ardhshme.

20 Jurisprudenca tregon se provat që Trupi Gjykses mund të
21 vlerësojë, të marrë parasysh për t'u bindur se nuk ka
22 shqetësime të sigurisë që e justifikojnë, përlligjin mbajtjen
23 në ndalim, përfshijnë edhe provat e personave të ndaluar. Për
24 të përcaktuar nëse të ndaluarit janë mbajtur në përputhje me
25 shqetësime të sigurisë legjitime dhe serioze, Dhoma e

1 Aktgjykimit në rastin Delacic kryesisht u mbështet në dëshminë
2 e dëshmitarëve se ata nuk kishin marrë pjesë në asnjë
3 aktivitet ushtarak që përbënte kërcënim autentik ndaj forcave
4 që mbanin nën kontroll zonën në fjalë. Dëshmitarët më tej
5 dëshmuar për mungesën e aktiviteteve, që nuk ishin marrë me
6 aktivitete politike dhe nuk kanë marrë pjesë në ndonjë grupim
7 për të mbrojtur fshatin. Tani i referohet paragrafit 113
8 [Sipas përkthimit] dhe 1134 të aktgjykimit.

9 Dhoma e Gjykimit nuk gjeti ndonjë arsye për të vënë në
10 pikëpyetje dëshmitë e këtyre dëshmitarëve dhe për të arritur
11 në përfundimin se nuk kishte, nuk ekzistonin shqetësimet e
12 sigurisë. Dhoma e Apelit të të TPNJ-së më tej miratoi këtë
13 qasje dhe këtë vlerësim.

14 Të nderuar Gjykatës, qasje të ngjashme janë miratuar dhe
15 adoptuar në çështjen Stanisic dhe Zupljanin dhe Perlic në
16 aktgjykimet ndaj tyre ku dhomat respektive janë mbështetur në
17 dëshminë e dëshmitarëve mbi profilin e të ndaluarve, rrethanat
18 në të cilat ata janë ndaluar fillimisht, dhe konstatoi se disa
19 të ndaluar janë mbajtur të ndaluar pa prova apo tregues që ata
20 kanë qenë të përfshirë në rebelim të armatosur apo aktivitete
21 subversive dhe/ose që -- pa ndonjë vlerësim individual të bërë
22 nga autoriteti që vendos për ndalimin e tyre të arsyeve të
23 sigurisë që mund të kishin çuar deri në ndalimin e tyre. I
24 referohem këtu çështjes së Stanisic dhe Zupljanin, aktgjykimit
25 të saj, paragrafi 222, 223 dhe aktgjykimit të apelit në të

1 njëjtën çështje, paragrafi 881.

2 Kërkoj ndjesë.

3 Aktgjykimi i apelit 881, 884; dhe aktgjykimi i mëpasshëm,
4 volumi 3, paragrafi 599, 950, 1001.

5 Tani do të kaloj te provat lidhur me mungesën e
6 shqetësimeve të sigurisë në këtë çështje. Siç e konstatoi
7 Trupi Gjykses në paragrafin 946 dhe 947 të aktgjykimit, akuzat
8 me të cilat përballeshin të ndaluarit janë një tregues që
9 vërtetojnë që paraqitja e pretendimeve apo akuzave të
10 mjegullta që janë për të -- që janë përdorur nga Trupi Gjykses
11 për të mbështetur konstatimet e tij se ndalimi ka qenë pa bazë
12 ligjore. Informacionit që iu është dhënë të ndaluarve lidhur
13 me arsyet e mundshme për ndalimin e tyre tregon se ata nuk
14 janë mbajtur të ndaluar për -- sepse ata përbënin dëm apo
15 rrezik të rëndë ndaj sigurimit të UÇK-së.

16 Sa i përket -- tani me kohën që më ka ngelur do t'ju jap
17 disa shembuj lidhur me këtë pikë.

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR] .

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR] .

4 [REDAKTUAR] ,

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR] .

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR] .

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR] .

24 Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi të shumta për akuza të tilla

25 të ngritura ndaj të akuzuarve të ndryshëm. Akuzoheshin se

1 ishin "shokë me serbët", po kjo është -- ky është një
2 pretendim i vagullt edhe i padrejtë dhe kjo nuk justifikon
3 ndalimin e një personi. Veç kësaj natyrat ishin sipërfaqësore
4 dhe të pabazuara dhe shumë prej të akuzuarve ishin objekt i të
5 njëjtave akuza me të njëjtat argumente. Por nuk u bë asnjë
6 vlerësim individual sa i takon ndalimit të secilit prej tyre.

7 Disa prej akuzave ishin kaq sipërfaqësore saqë tregonin
8 qartë se nuk ishte bërë asnjë përpjekje e njëmend për të
9 vërtetuar nëse vërtetë kishte kërcënime për sigurinë e vendit.
10 Për shembull, Dëshmitari T404 [Sipas përkthimit] tha se
11 hetuesit e kishin pyetur kë njihnin edhe veprimtaritë që
12 kishte pasur ai 18 vite përpara ndalimit të tij dhe më pas e
13 pyetën nëse kishte drejtuar ushtrinë serbe kundër popullatës
14 shqiptare. Tani po i referohem paragrafit 513 të aktgjykimit;
15 është prova P00156 dhe paragrafi 128 të aktgjykimit ku flitet
16 për të dhënat personale të personit në fjalë.

17 E ndaluara femër që përmendet me emër të paragrafin 564
18 të aktgjykimit u keqtrajtua sepse pretendohet se ajo kishte
19 marrëdhënie me serbët. Akuza të tilla, të përdor gjuhën e
20 Delacic, nuk janë "arsye e mjaftueshme" për të thënë se
21 personat për shkak të veprimtarive të tyre dhe njohurive të
22 tyre përfaqësojnë një kërcënim të njëmend të sigurisë aktuale
23 apo të ardhshme të një organi.

24 Po ashtu, disa prej tyre nuk kishin fare lidhje me krimet
25 për të cilat akuzoheshin, me zhvillimet e luftës. Për

1 shembull, Dëshmitari 01448 tha se i kishin thënë se e kishin
2 ndaluar se nuk kishte dhënë para të mjaftueshme për UÇK-në.
3 Kjo akuzë u përsërit disa herë që nga momenti i arrestimit të
4 tij, por edhe gjatë kohës që ai u mbajt i ndaluar. Këtu nuk
5 bëhet fjalë për kërcënime të sigurisë, ky ishin dhunime
6 personale të një individi për UÇK-në.

7 Të nderuar Gjykatës, provat që ka Trupi Gjykues
8 përfshinin edhe prova ku tregohej se të akuzuarit i kishin
9 mohuar pretendimet që ishin ngritur ndaj tyre. Për shembull,
10 Dëshmitari T11 në mënyrë të vazhdueshme i mohoi akuzat e
11 ngritura ndaj tij. Po dhe 01, në mënyrë të vazhdueshme dha
12 dëshmi dhe tha se "askush në familjen time nuk është as spiun
13 dhe as kolaboracionist". Dëshmitari T04-04 [REDAKTUAR]
14 [REDAKTUAR] tha se u trondit
15 kaq shumë nga një pretendim i tillë sa kishte ngelur pa fjalë.
16 Të nderuar Gjykatës, këtë që thashë mund ta gjeni në provën
17 P156, në faqen 9.

18 Këto mohime që ata i bënë asokohe por dhe më pas
19 mbështesin përfundimet e Trupit Gjykues se këta persona nuk
20 ishin aspak kërcënim për sigurinë dhe nuk duhet të ndaloreshin
21 këta persona t'u privohej liria mbi akuza të tilla.

22 Gjithashtu, duhet të përmendin se sjellja e UÇK-së në
23 fabrikën e Kukësit, thellon më tej argumentet se të ndaluarit
24 konsideroheshin si rreziqe për sigurinë. T4-05 dhe tri
25 muzikantët romë u lejuan të dilnin nga Dhoma 1 që të kryenin

1 punë të detyruar në ambientet e fabrikës. Kjo s'ka kuptim që
2 personat që mbahen të ndaluar për arsye se dyshohen se janë
3 kërcënim për sigurinë të lejohen sidoqoftë të dalin nga
4 ambienti ku mbaheshin të ndaluar dhe të kryenin punë në
5 ambientet e UÇK-së dhe këta nuk mund të konsideroheshin pastaj
6 rrezik dhe të sabotonin informacionet që kishin mbledhur.

7 Provat janë të parevokueshme. Personat që u mbajtën të
8 ndaluar në fabrikën metalit në Kukës nuk janë mbajtur të
9 ndaluar për akuza penale. Në pamje të parë akuzat, që u
10 ngritën për këta persona, si përdhunimi apo vrasja, duken të
11 rënda në natyrë, por rrethanat e këtyre personave dhe
12 keqtrajtimi i tyre e bën të qartë që në fakt nuk kanë qenë
13 këto akuza arsyeja.

14 Për shembull, TW4-01 u akuzua -- është akuzuar se

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR].

21 Gjatë kohës që ai keqtrajtohej, i njëjti ndaluar T01, tha
22 se i kishin thënë gjatë kohës që e keqtrajtonin, i kishin
23 thënë, pra, që në qoftë se ti pranon se ke kryer një vrasje,
24 atëherë do jesh i sigurt. Këtë mund ta shihnin dhe në
25 aktgjykim në paragrafin 404. Kjo nuk është në përputhje me

1 akuzat kriminale për vrasjeve penale.

2 Siç thashë më herët një dëshmitar tjetër, 04733 po ashtu
3 u akuzua se ishte vrasës edhe dhunues. Ndonëse nuk kishte
4 asnjë provë dhe ndonjë informacion konkret lidhur me viktimat
5 e pretenduara që paska vrarë apo dhunuar apo për vepra të
6 tjera penale për të cilat ai akuzua, ai nuk mund të përgjigjej
7 sepse sa herë që përpigjej të përgjigjej atë e rrihnin. Të
8 nderuar Gjykatës, akuzat kundër tij janë të pavërteta. Ai u
9 akuzua se kishte vrarë e dhunuar me qindra persona, por nuk ka
10 asnjë provë që të tregojë se është bërë ndonjë hetim në lidhje
11 me këto.

12 Po ashtu, krahas faktit që mungonte ndonjë informacion
13 konkret për këta të akuzuar, të ndaluar atyre nuk iu dha as
14 ndonjë dokument që të përlligjte arrestimin e tyre apo të
15 argumentoheshin veprat penale për të cilat dyshoheshin.

16 Personat që e arrestuan Dëshmitarin 01448 nuk i thanë për
17 llogari të kujt po vepronin, por më pas i thanë se do të
18 lirohej pasi t'i bëhej intervista apo gjykimi, por asnjëherë
19 nuk pati gjykim për këtë person. Këtë mund ta shihni në
20 paragrafin 491 deri në 493 të aktgjykimit.

21 Ai u akuzua se nuk kishte dhënë para të mjaftueshme për
22 UÇK-në dhe kjo minon çdo argument se ndalimi i tij ishte i
23 përlligjur për shkak të veprave penale që kishte kryer ky
24 person.

25 Pra, provat në këtë çështje gjyqësore mbështesin

1 përfundimet e Trupit Gjykues se të ndaluarit nuk janë mbajtur
2 për shkak të veprave penale që kishin kryer apo për shkak të
3 kërcënimit të sigurisë që e bënte të domosdoshëm ndalimin e
4 tyre. Provat që kanë dhënë dëshmitarët e ndryshëm, të marra në
5 tërësinë e tyre lidhur me regjimin e ndalimit mjaftojnë për të
6 justifikuar përfundimin e Trupit Gjykues.

7 Provat që kemi dhe përfundimet e Trupit Gjykues në
8 paragrafin 947 tregojnë se pretendimet e vagullta që u ngritën
9 kundër këtyre të ndaluarve mbështesin në fakt konstatimet e
10 Trupit Gjykues se ndalimi i tyre ka qenë i papërligjgur edhe
11 tregon se ka pasur natyrë të paligjshme të ndalimit të
12 viktimave në këtë lëndë gjyqësore.

13 Tani do t'ja jap fjalën kolegut tjetër që t'u përgjigjet
14 pyetjeve të Gjykatësve

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani do
16 t'u përgjigjem pyetjeve lidhur me Pikën 13. Pyetja e parë: A
17 mund të shpjegojnë palët standard *mens rea* të nevojshëm për
18 krimin e paligjshme dhe si mund të jetë ky efektiv për formën
19 e përgjegjësisë penale që është kryer, sidomos e kryer në
20 kushtet e NKP I, Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët I.

21 Të nderuar Gjykatës, ne pajtohemi me Mbrojtjen që *mens*
22 *rea* për vrasje përfshin si synimin e drejtpërdrejtë dhe
23 synimin e tërthortë. Sa i takon përkufizimit që ka përdorur
24 Trupi Gjykues dhe të miratuar në paragrafin 987 - më falni -
25 të miratuar nga Paneli i Apelit në aktgjykimin Mustafa në

1 paragrafin 388.

2 Ky është pra kufizimi -- përkufizimi i marrë parasysh që
3 do të thotë *mens rea* për vrasje i mbulon të dyja -- të dyja
4 situatat, dhe në rastet kur vdekja ka qenë synimi i dëshiruar
5 i sjelljes së një kryesi apo dhe situata kur ka qenë pasoja e
6 lëndimeve serioze dhe mostrajtimi i nevojshëm i plagëve që
7 shkaktoi një jetë njerëzore.

8 Për shembull, po i referohem tani përkufizimet në
9 Akayesu, është Gjykata Penale e Ruandës ku ka përkufizuar *mens*
10 *rea* për vrasje si synim për të vrarë një person apo për t'i
11 shkaktuar plagosje të rënda një personi, duke e ditur që kjo
12 plagosje mund të shkaktojë vdekje të këtij personit dhe
13 neglizhencë dhe kur kjo neglizhencë sjell vdekjen e një
14 individi.

15 Ka jurisprudencë në të drejtën zakonore ndërkombëtare
16 lidhur me këtë si për synimin e drejtpërdrejtë dhe synimin e
17 tërthortë që përkufizon vrasjen si krim lufte. Mund t'ju
18 rendis disa, nëse keni nevojë Perisic, paragrafi 104;
19 aktgjykimi Strugar, paragrafi 235, 236; aktgjykimi i apelit
20 Stugar, po ashtu, paragrafi 270. Janë të gjitha aktgjykime të
21 ish-TPNJ-së. Po ashtu ky parim pranohet në paragrafin 634 të
22 komentarit të KNKK-së në Konventën e Gjenevës III, neni 3, ku
23 përcaktohet qartë përkufizimi ku bëhet fjalë për vdekjen e
24 personave të mbrojtur edhe vdekja e personave për shkak të
25 neglizhencës që po ashtu në këtë rast do të konsiderohet

1 vrasje e paligjshme.

2 Në paragrafin 908 të aktgjykimit Celebici, Dhoma e TPNJ-
3 së konstatoi se rrahja e një viktime e kombinuar kjo me
4 problemet shëndetësore tregon synim për të vrarë ose për
5 shkaktuar plagosje të rëndë të personit dhe nuk merret
6 parasysh jeta e një personi dhe kjo është barasvlershme me
7 vrasje të paligjshme.

8 Ju na pyetët si mund të zbatohet ky standard kur një
9 person për vrasje të paligjshme gjykohet nën thjerrën e
10 Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët. Ka një lloj
11 barasvlefshmërie të *mens rea* që nevojitet për vrasje të
12 paligjshme dhe atë që nevojitet për NKP I.

13 Kjo mjafton për ta shpallur fajtor një person sipas NKP
14 I. *Mens rea* nuk ndryshon synimi, pra. Mund t'ju japim dhe
15 shembull në lidhje këtë. Dënimi i Khieu Samphan për shkak të
16 se ka qenë anëtari i NKP-së është thjesht për ilustrim. Në
17 këtë rast NKP III, ishte NKP III forma e përgjegjësisë penale.

18 Dhe për NKP I, në paragrafin 1054 të aktgjykimit të
19 apelit në Çështjen 02 data 23 nëntor 2016, Gjykata Supreme
20 dolën në përfundimin se për të shpallur fajtor një person për
21 vrasje të paligjshme me synim të drejtpërdrejt apo të
22 tërthortë, mjaftonte fakti që ky person kishte qenë pjesën e
23 NKP I.

24 Dhe kjo vërtetohet dhe më tej në paragrafin 162 të të
25 akuzuarit sepse i akuzuari në atë rast e dinte që sjellja e

1 tyre mund të rezultonte në vdekjen e një personi. Ky është
2 standardi i probabilitetit në këtë rast, jo të mundësisë, po
3 të probabilitetit që merret parasysh në NKP III.

4 Pra, siç e kemi bërë të qartë në paragrafin 255 të dosjes
5 sonë, Paneli mund ta kishte shpallur fajtor për NKP I edhe po
6 të kishte prova, që dhe në fakt provat e tregojnë këtë dhe do
7 të flasim dhe për këtë për një sekondë se apeluesi e
8 dëshironte në fakt vdekjen e viktimës dhe nëse vërtetonte se
9 apeluesi e dinte se viktima mund të vdiste për shkak të
10 veprimeve të tij.

11 Lidhur me marrëveshjen që kishin bërë anëtarët e NPK-së,
12 Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, pra, që i përmendi më së
13 paku dy herë Avokati Mbrojtës në parashtrimet e veta.

14 Prova që duhet të kishte një marrëveshje të qartë nuk
15 është domosdoshmëri sipas NKP-së, plani mund të ketë qenë
16 thjesht i përkohshëm dhe mund të ketë ndodhur për faktin se
17 pjesëmarrësit në një Ndërmarrje Kriminale të Përbashkët
18 veprojnë në mënyrë standarde, bashkë, të gjithë kanë një
19 qëllim të përbashkët. Ky parim është përcaktuar në rastin
20 Tadic, paragrafi 227 i aktgjykimit të apelit që është apeluar
21 vazhdimisht në aktgjykimin e Kvočka, paragrafi 906.

22 Tani pjesa e fundit e pyetjeve tuaja, nëse mund ta
23 shtjelloj më tej ZPS-ja çfarë prova ka përdor Trupi Gjykses
24 për të dalë në përfundimin se Shala kishte synim të
25 drejtpërdrejtë për të kryer krimin e vrasjes së paligjshme, në

1 kuadër të NKP I.

2 Do të doja ta bëja në seancë publike parashtrimin tim,
3 por do të përpiqem që të mos jap të dhëna konfidenciale, do
4 bazohem tek aktgjykimi i redaktuar publik.

5 Trupi Gjykses me të drejtë tha që anëtarët e NKP-së, po i
6 referohem paragrafit 990 të aktgjykimit, përfshirë apeluesin,
7 z. Shala në këtë rast, ju lutem shikoni paragrafin 1033,
8 kishin synim të drejtpërdrejtë për të kryer vrasje të
9 paligjshme dhe *mens rea* për krim, përfshirë vrasjen e
10 paligjshme, mund të jetë ndonjëherë e drejtpërdrejtë ose mund
11 të ndodhë për shkak të rrethanave të çastit. Dhe kemi provat
12 në këtë lëndë gjyqësore për këtë. Ka parim të mirëngritur për
13 këtë, është aplikimi Brdjanin, aktgjykimi Celebici lidhur me
14 këtë që ju mund ta shihni dhe ka dhe jurisprudencë të
15 mëtutjeshme.

16 Trupi Gjykses konstatoi se z. Shala veprroi me synim të
17 drejtpërdrejtë dhe është bazuar për këtë në tri rrethana: Se
18 ka marrë pjesë fillimisht në rrahjet e 20 majit, paragrafi 132
19 i aktgjykimit; ka marrë pjesë në keqtrajtimin e 4 qershorit,
20 paragrafi 1034 i aktgjykimit dhe deklaratat apo deklaratat që
21 i bëri ai vetë Dëshmitarit 47333 [Sipas përkthimit] kur i tha
22 se do të ekzekutojmë. Ju lutem shikoni paragrafin 1033.

23 Do jua shpjegoj arsyet tani. Sjellja -- provat që kemi ne
24 për sjelljen e z. Shala më 20 maj dhe 4 qershor nuk lenë
25 dyshime për faktin që ai kishte synim për të kryer vrasjen e

1 paligjshme. Këtë mund ta shikoni në deklaratën që ka -- i bëri
2 ai vetë Dëshmitarit 4733 kur vetë z. Shala i tha atij që do të
3 ekzekutohesh.

4 Pjesëmarrja e z. Shala në rrahjet e 20 majit 1999,
5 pavarësisht se viktima kishte gjakderdhje dhe u alivanos,
6 tregon që z. Shala kishte synim të drejtpërdrejtë.

7 Z. Shala në veprimet e 4 qershorit tregon se z. Shala
8 donte, e dëshironte vdekjen e viktimës së paligjshme.

9 Ju ftoj, të nderuar Gjykatës, të keni parasysh se çfarë
10 pa z. Shala më 4 qershor të 1999-s. Ai kishte dijeni se çfarë
11 do të sillte sjellja e tij domethënë. Kjo -- për këtë ka
12 jurisprudencë, mund të shikoni çështjen Stanisic dhe
13 Simatovic, Dhoma e Apelit e Mekanizmit. Është dhe aktgjykimi
14 31 majit 2023, ju lutem paragrafët 525, 529, 535. Pra kur ke
15 dijeni për rrethana të caktuara dhe këto janë të mjaftueshme
16 për të gjykuar *mens rea* e një personi.

17 Dhoma e Apelit e la në fuqi këtë kur vlerësoi
18 përgjegjësinë krenare të një personi për vrasje të paligjshme
19 sipas NKP I.

20 Të nderuar Gjykatës, nëse merrni parasysh çfarë pa dhe
21 dinte z. Shala kur vetë ai u përfshi në keqtrajtimin e
22 viktimës së vrasjes të paligjshme, atëherë përfundimi i vetëm
23 të çon të mendosh sa ai ndante synimin me të tjerët për të
24 kryer një vrasje të paligjshme.

25 Trupi Gjykues konstatoi se z. Shala në paragrafin 1034 të

1 ka qenë i pranishëm kur anëtarët e tjerë të NKP-së e qëlluan
2 me armë viktimën, i cili filloi të kishte gjakderdhje për
3 shkak të qëllimit me armë. Pavarësisht se sa e rëndë ishte
4 plaga që i shkaktuan këtij personi, kryesit, përfshirë z.
5 Shala vijuan ta rrihnin viktimën e vrasjes së paligjshme deri
6 në mëngjesin e ditës tjetër.

7 Kjo është shumë e rëndësishme, e kanë thënë disa
8 dëshmitarë, e ka thënë dhe eksperti i mjekësisë ligjore dhe na
9 kanë treguar qartë se çfarë duhet të ketë parë z. Shala e ta
10 ketë kuptuar se çfarë do të ndodhte. Ka pasur dijeni të qartë
11 se çfarë do të sillte sjellja e tij -- çfarë pasojash do të
12 kishte sjellja e tij.

13 Eksperti i mjekësisë ligjore i Prokurorisë, Dr. Gasior,
14 dëshmoi dhe tha se plaga me armë zjarri që i shkaktuan
15 viktimës dëmtoi totalisht arterien e viktimës së vrasjes së
16 paligjshme dhe i dëmtoi arterien kryesore dhe mund ta kishte
17 ndaluar gjakderdhjen vetëm një ndërhyrje e menjëhershme
18 kirurgjikale. Kjo përputhej dhe me dëshmitë e dëshmitarëve të
19 tjerë që kanë thënë se kur e sollën viktimën e vrasjes së
20 paligjshme [REDAKTUAR] nuk po mundnin t'ia ndalonin
21 gjakderdhjen. Biles Dëshmitari 1448 flet shumë në lidhje me
22 këtë. Po përpiqem ta kuptoni ju, të nderuar Gjykatës, se sa
23 gjak kishte humbur ky person. Të njëjtën sasi gjaku e pa dhe
24 z. Shala me sytë e tij. Qebet që u përdoren për t'u përpjekur
25 për të ndaluar gjakderdhjen u bënë të kuqe, u lagën aq shumë

1 me gjak nga viktima e vrasjes së paligjshme.

2 Çdo person do ta kishte kuptuar se sa e rëndë ishte e
3 gjendja e këtij personi. Çdo person do arrinte ta kuptoni.
4 Edhe z. Shala ishte një prej këtyre personave. Ai ishte një
5 ushtar atje i cili vetëm disa ditë përpara vrasjes kishte
6 shkuar me automjet i plagosur nga fusha e betejës. Për këtë që
7 po flas tani mund t'ju referoheni provës P139, faqe 141, 143,
8 145. Pra, nuk ka dyshim që ka qenë në dijeni se plaga ishte e
9 rëndë, plaka që iu shkaktua viktimës ishte e rëndë dhe
10 sidoqoftë nuk e ndaluan keqtrajtimin.

11 Ka provat të qarta lidhur me synimin e drejtpërdrejtë.
12 Dhe kjo ka prova që mbështesin konstatimet e Trupit Gjykses
13 lidhur me sjelljen e z. Shala të 20 majit dhe se çfarë i tha
14 një dëshmitari tjetër, i cili për fat të mirë arriti të
15 shpëtonte gjallë.

16 Për të përfunduar, me të drejtë Trupi Gjykses doli në
17 përfundimin se z. Sala kishte -- z. Shala - më falni - kishte
18 synim të drejtpërdrejtë për të kryer vrasjen. Pra, ai ka
19 përgjegjësi penale sipas NPK I. Ai duhet të kishte ditur që
20 lëndime e shumta që i shkaktuan viktimës mund të kishin çuar
21 në vdekjen e tij. Pra nuk ka dyshim se z. Shala kishte synim
22 që ta vriste.

23 Me kaq do të mbyll parashtrimet e mia për momentin. Do
24 t'ju përgjigjem në qoftë se keni pyetje të mëtejshme për
25 momentin qoftë unë apo kolegja ime.

1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Kam parasysh kohën. Unë në fakt
2 kam më shumë për të thënë se nëntë minuta lidhur me dënimin.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Nuk mendoj
4 se mund të vazhdojmë më për sot. A mund të përfundoni nesër
5 paradite?

6 [Trupi Gjykses dhe Juristja këshillohen]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mund të
8 filloni nëse dëshironi tani. Mund të filloni tani dhe të
9 përfundoni parashtrimin tuaj nesër në qoftë se është e mundur
10 për ju. E di që nuk është e lehtë ndonjëherë ta ndash fjalën,
11 argumentin.

12 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nëse është parapëlqimi juaj
13 atëherë kështu do të vazhdojmë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do
15 parapëlqesha që kështu të vijonim, por më lejoni një çast të
16 konsultohem.

17 [Trupi Gjykses dhe Juristja këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Pasi u
19 konsultuam me njëri-tjetrin dhe me juristen vendosëm kështu,
20 do bëjmë ne pyetjet tani që të keni mundësi të reflektoni dhe
21 të përgatiteni deri nesër. Dhe mund të përfundoni për pikën 14
22 nesër. Dhe sa kohë mendoni se do ju nevojitet për pikën 14?

23 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Rreth 15-20 minuta. Mendoj se
24 nevojiten rreth 15-20 minuta për pikën 14.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.

1 Mirë. Ne po bëjmë pyetjet, nëse jeni dakord edhe ju, dhe
2 ju vazhdoni parashtrimin tuaj nesër.

3 Mesa kuptoj, z. De Minicis, ju thatë, nëse e kuptova
4 drejt, thatë që do të na jepni dhe referenca me shkrim për
5 Pikën 7, të pyetjen 1 lidhur me Pikën 7.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull
8 atëherë. Ju lutem na jepni nesër referencat nesër paradite.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E keni fjalën gjatë seancës?
10 Doni ta bëj gjatë seancës, të jap referencat gjatë seancës?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Me shkrim,
12 me shkrim, me shkrim. Në qoftë se i keni që tani.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk i kam tani.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull
15 atëherë, nesër. Dëshët të thonit diçka?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për
17 ndërhyrjen, pak më përpara fola për dëshminë e dëshmitarit --
18 kur foli për qebet me gjak, bëhen fjalë për 1448, Dëshmitarin
19 1448 edhe e përmenda edhe referencat. Është provë gjyqësore
20 kjo. Po jap ERN SITF0013852-0013869 RED6 në faqen SIT00013859.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
22 Faleminderit. Kush dëshiron të fillojë? Gjykatësi Ambos ka
23 pyetje.

24 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Më
25 dëgjoni?

1 Z. DE MINICIS: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit për shpjegimet
3 tuaja. Kam dy grupime pyetjesh: një lidhur me ndalimin
4 arbitrar dhe pyetje të tjera lidhur me NKP-në.

5 Po filloj me një deklaratë që sapo bëtë.

6 "Jurisprudenca tregohen se provat që Trupi Gjykues mund
7 të marrë parasysh për të përmbushur kriterin se nuk ekzistonin
8 -- se kërcënimet e sigurisë nuk e përlligjin ndalimin, përfshin
9 provat e personave të ndaluar".

10 Kam dy pyetje lidhur me këtë që sapo thatë. Së pari: A ka
11 ndonjë element që faktikisht bëjnë dallimin mes rasteve të
12 ish-Tribunalit të Hagës që përmendët ju nga kjo lëndë
13 gjyqësore. Pra, kur provat e personave të ndaluar nuk mund të
14 jenë konkluzive për standardin relevant -- përfundimtare apo
15 decizive për standardin përfundimtar.

16 Pyetja e dytë: A mund të komentojnë palët për provat e
17 tjera që janë pjesë e dokumentacionit gjyqësor që nuk burojnë
18 nga personat e ndaluar që janë relevante për konstatimet e
19 Trupin Gjykues, në paragrafin 947 se të ndaluarit "nuk janë
20 mbajtur ndaluar në fabrikë për shkak të veprave penale dhe se
21 nuk ekzistonte asnjë shqetësim për sigurinë, ç'ka të përlligjte
22 ndalimin e tyre", mbyll citimin.

23 Pyetja ime e tretë, nuk e kam fjalën për deklaratën tuaj,
24 e kam pyetje më hipotetike këtë: Në një situatë ku kemi një
25 konflikt të armatosur si konflikti në fjalë, a nuk është e

1 imagjinueshme që një palë në konflikt të mendojë, a nuk është
2 normale që ndonjëherë një palë në konflikt të mendojë që pala
3 tjetër po përdor persona për të na spiunuar? Pra, është e
4 paimagjinueshme kjo për ju? Në këtë konflikt të armatosur dhe
5 përgjithësisht në konfliktet e armatosura a nuk ndodh kjo gjë?
6 Pra, është e paimagjinueshme kjo për ju, që një person të
7 imagjinojë, mbase dhe gabimisht, po t'i shkojë mendja se
8 personat e palës tjetër në konflikt mund të kenë përdorur
9 persona, mund t'i shfrytëzojnë si spiunë. Ekzistojnë skenare
10 të tilla. Mund të jenë gabim apo jo, për ekzistojnë.

11 Sa i takon ndërmarrjes kriminale të përbashkët, kam disa
12 dyshime, të them të drejtën.

13 Së pari, po supozoni ju se vrasja e personave të ndaluar,
14 po thoni, që ka qenë pjesë e ndërmarrjes kriminale të
15 përbashkët të lëndës tonë gjyqësore? Nëse po, synimi që
16 nevojitet për këtë, për vrasjen konkrete, është i njëjti synim
17 si synimi që zbatohet përgjithësisht për ndërmarrjen kriminale
18 të përbashkët? Me fjalë të tjera, synimi i dyfishtë në NKP,
19 pra, duhet të ketë një synim të mirëngritur apo të ketë një
20 synim konkret për krimin konkret, për shembull, për vrasjen e
21 personit në fjalë. Pra, është e përgjithshme kjo si e kuptoni
22 ju NPK-në?

23 Pra, si e kuptoni ju synimin se ju bëtë disa komente
24 interesante dhe ju thatë se ka pasur marrëveshje. Këtë pyetje
25 kam dhe për Mbrojtjen. Nëse ka pasur marrëveshje, do të thotë

1 që synimi këtu përfshin edhe synimin e tërthortë. E kuptova
2 unë drejt? Ju thatë që s'ka pasur mosmarrëveshje mes palëve.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne e mendojmë që përfshihet
4 edhe synimi i tërthortë. Më duket se këtë e tha edhe pala
5 tjetër.

6 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Mbase nesër mund të na thoni
7 diçka lidhur me mënyrën si e kuptoni ju synimin e tërthortë jo
8 të drejtpërdrejtë pra. Dhe ky synimi i jo -- i tërthortë, si e
9 shpjegoni ju këtë? Mund të na e shtjelloni ju pak më shumë? Si
10 e kuptoni ju synimin e tërthortë? Okej, ju thoni që e marrim
11 të mirëqenë që ka pasur synim të drejtpërdrejtë dhe ka prova
12 për këtë, po unë dua të më shpjegoni më tej si e kuptoni ju
13 synimin e tërthortë.

14 Këto janë disa nga pyetjet që mund të reflektoni gjatë
15 darkës dhe nesër të më ktheni përgjigje. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
17 Faleminderit. Tani Gjykatësja Jorgensen e ka fjalën për
18 pyetjet e radhës.

19 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Dëshmitar. Pyetja ime ka
20 të bëjë me Pikën 7 dhe çfarë interpretimi i jep Prokuroria
21 rregullës 144(a) e rregullores. Ju thatë që dëshmitë e
22 paverifikuara nuk janë vendimtare për sa i takon një incidenti
23 të vetëm si ky, për shembull, por do të doja të dija se çfarë
24 interpretimi keni ju lidhur me këtë rregull të rregullores.
25 Sipas jush rregullorja a e lejon Trupin Gjykses që të

1 mbështetet vetëm dhe në mënyrë vendimtare në dëshmitë e
2 pavërtetuar për të konstatuar vendime fajësie për incidente
3 penale. Dhe do të doja gjithashtu që t'i referoheshit
4 jurisprudencës përkatëse. Për shembull, për të qenë më
5 konkrete ZPS-ja i është referuar aktgjykimit Popovic dhe të
6 tjerët në nivel apeli, dhe më konkretisht këtu e kam fjalën
7 për poshtëshënimin 501 të dosjes tuaj. Dhe gjithashtu keni
8 cituar edhe aktgjykimin kundër Karadzic në nivel apeli.

9 Kështu që do të doja që të dija se çfarë mendimi keni ju
10 lidhur me këtë dhe në fakt është një pyetje që i drejtohet të
11 dyja palëve.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Nuk ka
13 pyetje tjera. Kështu që do ta mbyllim këtu seancën e ditës së
14 sotme. Do të vazhdojmë nesër përsëri në orën 10.00 paradite.
15 Nesër do të fillojmë me fundin e parashtimeve të Prokurorisë
16 sipas nenit 14, do vazhdojmë më tej me përgjigjen e pyetjeve
17 që sapo i bëmë dhe do vazhdojmë më tej me përgjigjet e
18 Mbrojtjes së Viktimave. Dhe në fund fare do t'i japim përsëri
19 fjalën Avokati të z. shala për të dhënë në përgjigjen e vet.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
21 na jepni ca udhëzime sa i takon afateve që kemi për sa i takon
22 dorëzimit të listës së dëshmimeve që mbështesin keqtrajtimin pas
23 aktgjykimit me shkrim. Domethënë, nuk e kam shumë të qartë në
24 goftë se mund të na e shpjegoni pak më tepër se kur është
25 afati më konkretisht. Mund të na e thoni këtë?

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

2 [Trupi Gjykses dhe Juristi këshillohen]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Sa kohë ju
4 nevojitet? Disa ditë ndoshta apo më thoni?

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, do ishte në rregull në
6 qoftë se na jepni disa ditë

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Deri në
8 hënë.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, patjetër, deri të hënë
10 është në rregull.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Seanca mbyllet këtu.

14 --- Seanca mbyllet në orën 17.36

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25